dal in nga kjo Rregullore ndëshkohet sipas Ligjit nr. 03/L-203 për Metrologjinë ose gjegjësisht Ligjit nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit. KAPITULLI 6 DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE Neni 35 Dispozitat shfuqizuese 1.Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohen: 1.1.Udhëzimi Administrativ nr.. 2006/22 për kërkesat tekniko-metrologjike për njehsorët statikë të energjisë elektrike aktive të klasës së saktësisë 1 dhe 2; 1.2.Udhëzimi Administrativ nr.. 2006/24 për kërkesat tekniko-metrologjike për njehsorët induktivë të energjisë elektrike. Neni 36 Dispozitat kalimtare 1. Neni 22 i cili ndërlidhet me detyrimin për të njoftuar Komisionin Evropian të BE-së aplikohet nga dita e aderimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian. 2. Para aderimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian të gjitha certifikatat dhe	under this Regulation shall be penalized according to the Law No. 03/L-203 on Metrology or the Law No. 04/L-039 on Technical Requirements for Products and Conformity Assessment, respectively. CHAPTER 6 TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS Article 35 Repealing provisions 1.The entry into force of this Regulation repeals: 1.1.Administrative Direction No. 2006/22 on technical – metrological requirements for active electrical energy static meters of 1 and 2 accuracy class; 1.2. Administrative Direction No. 2006/24 on technical – metrological requirements for electrical energy inductive meters. Article 36 Transitional provisions 1. Article 22 which relates to an obligation to notify the European Commission of the EU shall be applied from the day of accession of the Republic of Kosovo to the European Union. 2. Before the accession of the Republic of Kosovo to the European Union all certificates	Uredbe kazniće se u skladu sa datim Zakonom br. 03/L-203 o Metrologiji ili na osnovu Zakona br. 04/L-039 o tehničkim zahtevima za proizvode i ocenjivanju usaglašenosti. POGLAVLJE 6 PRELAZNE I KONAČNE ODREDBE Član 35 Odredbe o prestanku važenja 1.Stupanjem na snagu ove uredbe prestaje da važi: 1.1.Administrativno uputstvo br. 2006/22 o tehničkim - metrološkim zahtevima za statička brojila aktivne električne energije klase tačnosti 1 i 2; 1.2. Administrativno uputstvo br. 2006/24 o tehničkim - metrološkim zahtevima za induktivna brojila električne energije. Član 36 Prelazne odredbe 1. Član 22 koji se odnosi na obavezu da se obaveste Evropskoj komisiji o EU primenjivaće se od dana pristupanja Republike Kosova u Evropsku uniju. Pre pristupanja Republike Kosova u Evropskoj uniji svi sertifikati i druga
--	--	---

dokumentet tjera specifike të konformitetit të lëshuara në mënyrë të ligjshme nga trupat e vlerësimit të konformitetit, të cilat shtetet anëtare të Bashkimit Evropian i kanë lajmëruar në Komisionin Evropian, regjistri i të cilave është publikuar në “Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian”, pranohen/njihen nga organi përkatës shtetëror që është përgjegjëse për metrologji.	and other specific conformity assessment documents lawfully issued by conformity assessment bodies, that have been notified by the Member States of the European Union to the European Commission and the list of which has been published in the Official Journal of the European Union, shall be accepted /recognized by the respective national body which is in charge of the metrology.	dokumenta za procenu specifične usaglašenosti zakonito izdate od tela za ocenjivanje usaglašenosti, koji procene konformiteta su obavljene od organa za procenu konformiteta, države članice koje su države članice Evropske unije prijavile Evropskoj komisiji, čiji je registar objavljen u “Službenom listu Evropske unije, biće prihvaćeni/priznati od strane državni organe koji je zadužena za metrološku.
3. Mjetet matëse që janë të shoqëruara me dokumentet e konformitetit, të cilat vërtetohen se këto mjete matëse janë në përputhshmëri me kushtet dhe kriteret e kësaj Rregullore, pranohen, regjistrohen dhe vihen në dispozicion për tregun dhe/ose përdorim në pajtim me dispozitat e nenit 24 të Ligjit Nr. 03/L-203 për metrologji.	3. Measuring instruments that are associated with conformity documents, which confirm that these measuring instruments in accordance with the terms and conditions of this Regulation shall be received, recorded and made available to the market and/or use in accordance with the provisions of Article 24 of the Law No. 03/L-203 on metrology.	3. Merni uređaji koji su povezani sa dokumentima o usaglašavanju, čime je potvrđeno da su ovi merni instrumenti u skladu sa uslovima iz ovog pravilnika, primljene, evidentirati i učiniti dostupnim na tržištu i/ili koriste u skladu sa odredbama člana 24 zakon br . 03 / L - 203 o metrologiji.
4. Nëse organi përkatës që është përgjegjëse për metrologji, konstaton se dokumentet e konformitetit nuk janë në përputhshmëri me legjislacionin e zbatueshëm, atëherë organi përkatës që është përgjegjëse për metrologji e njofton operatorin ekonomik me shkrim për mospranimin e dokumenteve të konformitetit.	4. If the relevant body that is responsible for metrology, conform that the conformity documents are not in compliance with applicable legislation, the relevant body that is responsible for metrology shall notify the economic operator in writing for non acceptance of the conformity documents.	4. Ukoliko nadležni organ koji je odgovoran za metrologiju, usaglašenosti utvrdi da dokumenti nisu u skladu sa važećim zakonima, nadležni organ koji je odgovoran za metrologiju ekonomskog operatera će u pisanoj formi obavesti da odbacivanje usklađenosti dokumenata.
5. Pala e pakënaqur të cilës iu është refuzuar mospranimi për regjistrim, mund të parashtroj ankesë në përputhshmëri me dispozitat e paragrafit 3 të nenit 13A të Ligjit Nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-203 për Metrologji.	5. Unsatisfied party whose objection has been rejected for registration may file a complaint in accordance with the provisions of paragraph 3 of Article 13A of Law No. 04 / L-124 on amending and supplementing the Law no. 03 / L-203 on Metrology.	5. Nezadovoljna stranka čiji je prigovor je odbijen za registraciju, može da uloži žalbu u skladu sa odredbama stava 3 člana 13a Zakona br . 04/L - 124 o izmeni i dopuni Zakona br . 03/L - 203 o metrologiji .

Neni 37 1. Dispozitat e kësaj Rregullore për detyrimin për ngjitjen e shenjës CE dhe shenjës plotësuese të metrologjisë në mjetet matëse dhe Shtojcat I deri XIII për identitetin vizual të shenjave aplikohen nga dita e aderimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian. 2. Mjetet matëse që i përmbushin të gjitha kriteret sipas aktit juridik të referuar në nenin 1, paragrafi 2 të kësaj Rregullore dhe që janë shënuar në mënyrë të ligjshme me shenjën CE dhe shenjën plotësuese të metrologjisë, nuk do të ndalohen, për arsyt që mbulohen me këtë Rregullore, kur të vihen në dispozicion për tregun dhe/ose të vendosen në përdorim.	Article 37 1. Provisions of this Regulation on the obligation to affix CE marking and supplementary metrology marking on measuring instruments and Annexes I to XIII on the visual identity of markings shall be applied from the day of accession of the Republic of Kosovo to the European Union. 2. Measuring instruments which fulfil all the requirements according to the legal act referred to in Article 1 paragraph 2 of this Regulation and are lawfully marked with CE marking and supplementary metrology marking shall not be impeded, for reasons covered by this Regulation, when made available on the market and/or put into use.	Član 37 1. Odredbe ove Uredbe u vezi sa obavezom postavljanja CE oznake i dodatno metrološko obeležavanje na mernim instrumentima i Aneksima I do XIII o vizuelnom identitetu oznaka treba da se primenjuju do dana pristupanja Republike Kosovo u Evropsku uniju. 2. Merni instrumenti koji ispunjavaju sve zahteve u skladu sa aktom iz člana 1, paragraf 2 iz ove Uredbe i propisno obeleženi sa CE oznakama i dopunskim metrološkim obeležavanjem se ne uklanjaju, iz razloga koje pokriva ova Uredba, ako su dostupni na tržištu i/ili stavljeni u upotrebu.
Neni 38 1. Deri në ditën e aderimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, termet e përdorura në këtë Rregullore e kanë kuptimin vijues: 1.1. Deklarata e konformitetit e BE-së nënkupton -deklaratën e konformitetit; 1.2. Certifikata e ekzaminimit të llojit të BE-së, nënkupton certifikatën e ekzaminimit të llojit; 1.3. Certifikata e ekzaminimit të dizajnit të BE-së, EU nënkupton certifikatën e ekzaminimit të dizajnit.	Article 38 1. Until the day of accession of the Republic of Kosovo to the European Union the terms used in this Regulation have the following meaning: 1.1. EU declaration of conformity means declaration of conformity; 1.2. EU-type examination certificate means type examination certificate; 1.3. EU design examination certificate means design examination certificate.	Član 38 1. Do dana pristupanja Republike Kosova u Evropskoj uniji izrazi koji su upotrebljeni u ovoj Uredbi imaju sledeće značenje: 1.1 EU deklaracija o usaglašenosti podrazumeva deklaraciju o usaglašenosti; 1.2. EU tip sertifikata o pregledu podrazumeva tip sertifikata o pregledu; 1.3. EU Sertifikat o pregledu dizajna podrazumeva sertifikat o pregledu dizajna.

Neni 39 Periudha kalimtare Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, mjetet matëse të cekura në nenin 2 të kësaj Rregullore, të cilat kanë verifikimin e parë të vlefshëm, në përputhje me dispozitat e Udhëzimeve Administrative të parapara në nenin 38 të kësaj Rregullore dhe të cilat plotësojnë kërkesat e atyre dispozitave, mund të hidhen në verifikim të rregullt apo të jashtëzakonshëm sipas këtyre udhëzimeve, deri në skadimin e vlefshmërisë së miratimit të tipit të tyre, të miratuara nga ato udhëzime, për sa kohë që ato përmbushin kërkesat nga udhëzimet, në bazë të të cilave ato janë vënë në përdorim.	Article 39 Transitional period On the day of entry into force of this Regulation, measuring instruments mentioned in the Article 2 of this Regulation, which have the first valid verification, in accordance with the provisions of the Administrative Instructions stipulated in Article 38 of this Regulation, and which meet the requirements laid down in those provisions, may enter the regular or extraordinary verification according to these instructions, until the expiration of the validity of the approval of their type, approved by these instructions, as far as they meet the requirements deriving from those instructions, based on which they were put for use.	Član 39 Prelazni period Od stupanja na snagu ove Uredbe, merna sredstva navedena u članu 2, ovog pravilnika, koje imaju prvu važeću proveru, u skladu sa odredbama, sa Administrativna određene u člana 38 ove Uredbe, a koje ispunjavaju uslove tih odredbi, mogu se stavljati na redovnu ili vanrednu proveru prema ovim uputstvima, do isteka roka važenja odobrenja njihovog tipa, usvojenih od tih uputstava, dok one ispunjavaju zahteve uputstava, prema kojima su stavljene u upotrebu.
Neni 40 Hyrja në fuqi Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas nënshkrimit nga Ministri e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.	Article 40 Entry into force This Regulation enters into force 7 (seven) days after it is signed by the Minister of the Ministry of Trade and Industry.	Član 40 Stupanje na snagu Ova Uredba stupa na snagu 7 (sedam) dana nakon što je potpisana od strane Ministra u Ministarstvu za trgovinu i industriju.

Hykmete Bajrami Ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë Datë 23.08.2016	Hykmete Bajrami Minister of the Ministry of Trade and Industry Date 23.08.2016	Hykmete Bajrami Ministarka za Trgovinu i Industriju Datum 23.08.2016
---	---	---

SHTOJCA I KËRKESAT THEMELORE

Një mjet matës duhet të siguroj nivel të lartë të mbrojtjes metrologjike në mënyrë që çdo palë e prekur mund të ketë besim në rezultatin e matjes, dhe do të jetë i projektuar dhe prodhuar në një nivel të lartë të cilësisë në lidhje me teknologjinë e matjes dhe sigurinë e të dhënave të matjes.

Kërkesat themelore të cilat duhet të përmbushen nga mjete matëset matëse janë paraqitur më poshtë dhe janë plotësuar sipas rastit, nga kërkesat e mjete matëseve specifike në Shtojcat III deri në XII që ofrojnë më shumë detaje në disa aspekte të kërkesave të përgjithshme.

Zgjidhjet e referuara në përmbushjen e kërkesave themelore duhet të marrë parasysh përdorimin e parashikuar të mjetit matës dhe çdo keqpërdorim të parashikueshëm të tij.

PËRKUFIZIMET

Sasia për matje	Sasia për matje është sasia e veçantë që duhet të matet.
Sasia ndikuese	Sasia ndikuese është sasia e cila nuk është sasia për matje por që ndikon në rezultatin e matjes.
Kushtet e vlerësuara funksionale	Kushtet e vlerësuara funksionale janë vlerat për sasinë e matjes dhe sasinë ndikuese të cilat përbëjnë kushtet normale të punës së një mjeti matës. Vlerësuar Kushtet Operative Të vlerësuarat kushtet operative janë vlerat për Madhësia e matur dhe ndikimi quan tities përbëjnë kushtet
Çrregullimet	Një sasi ndikuese që ka vlerë brenda kufijve të përcaktuar në kërkesën e duhur, por jashtë kushteve të vlerësuara funksionale të specifikuara të mjetit matës. Një sasi ndikuese është çrregullim nëse për këtë sasi ndikuese nuk janë specifikuar kushtet e vlerësuara funksionale.
Vlera kritike e ndryshimit	Vlera kritike e ndryshimit është vlera me të cilën ndryshimi në rezultatin e matjes është konsideruar i padëshirueshëm.
Matja materiale	Matja materiale është një pajisje që ka për qëllim riprodhimin ose furnizimin në mënyrë të përhershme gjatë përdorimit të saj të një ose më shumë vlerave të njohura të një sasive të caktuar.
Shitje direkte	Një transaksion tregtar është shitje direkt nëse: — Rezultati i matjes shërben si bazë për çmimin për të paguar; dhe — Të paktën një nga palët e përfshira në transaksion në lidhje me matjen është një konsumator ose ndonjë palë tjetër që kërkon një nivel të ngjashëm të mbrojtjes; dhe — Të gjitha palët në transaksion pranojnë rezultatin e matjes në atë kohë dhe vend.

Mjedise klimaterike	Mjedise klimaterike janë kushtet në të cilat mund të përdoren mjete matëset matëse. Për të përballuar ndryshimet klimaterike të shteteve anëtare, janë përcaktuar kufijtë e temperaturës.
Shërbimet komunale	Si të tilla konsiderohen furnizimi me energji elektrike, gaz, energji termike ose ujë.

KËRKESAT THEMELORE

1. Gabimet e lejuara

- 1.1. Sipas kushteve të vlerësuara funksionale dhe në mungesë të çrregullimeve, gabimi i matjes nuk duhet të kalojë vlerën e gabimit maksimal të lejuar (Maximum Permissible Error) e cila përcaktohet në kërkesat e caktuara specifike të mjete matëseve.

Nëse nuk shprehet ndryshe në shtojcat specifike të mjetit matës, MPE është shprehur si vlerë bilaterale e devijimit nga vlera e vërtetë e matjes.

- 1.2. Sipas kushteve të vlerësuara funksionale dhe në prani të ndonjë çrregullimi, kërkesat e ecurisë do të përcaktohen në kërkesat e caktuara specifike të mjete matëseve.

Ku mjeti matës ka për qëllim të përdoret në një fushë elektromagnetike të caktuar të përhershme, të vazhdueshme, ecuria e lejuar gjatë fushës elektromagnetike rrezatuese-testi i amplitudës së moduluar duhet të jetë brenda MPE.

- 1.3. Prodhuesi duhet të specifikojë mjediset klimaterike, mekanike dhe elektromagnetike në të cilat ka për qëllim të përdoret mjeti matës, furnizimin me energji elektrike dhe sasitë e tjera me ndikim të cilat kanë gjasa të ndikojnë në saktësinë e tij, duke marrë parasysh kërkesat e caktuara në shtojcat specifike për mjetin matës.

1.3.1. Mjediset klimaterike

Prodhuesi duhet të specifikojë kufirin e lartë të temperaturës dhe kufirin më të ulët të temperaturës nga ndonjë prej vlerave në Tabelën 1, përveç nëse specifikohen ndryshe në shtojcën III deri në XII, dhe tregojnë nëse mjeti matës është projektuar për lagështirë të kondensuar ose jo të kondensuar, si dhe vendin e përcaktuar për mjetin matës, d.m.th i hapur ose i mbyllur.

Tabela 1

	Kufijtë e temperaturës				
Kufiri i lartë i temperaturës	30 °C	40 °C	55 °C	70 °C	
Kufiri i ulët i temperaturës	5 °C	– 10 °C	– 25 °C	– 40 °C	

- 1.3.2.(a) Mjediset mekanike klasifikohen në klasat M1 deri në M3 si janë përshkruar më poshtë.

M1	Kjo klasë aplikohet te mjete matëset e përdorura në vende me dridhje dhe goditje të ulëta, p.sh. mjete matëse të lidhur me strukturat mbështetëse të lehta që i nënshtrohen dridhjeve dhe goditjeve të papërfillshme të transmetuara nga shpërthimi lokal ose aktivitetet grumbull-lëvizëse, përplasja e dymve, etj.
M2	Kjo klasë aplikohet te mjete matëset e përdorur në vende me nivele të konsiderueshme apo të larta të dridhjes dhe shokut, p.sh. të transmetuara nga makinat dhe automjetet që kalojnë në afërsi ose ngjitur me makinat e rënda, shirita transportues, etj.
M3	Kjo klasë aplikohet te mjete matëset e përdorura në vendet ku niveli i dridhjes dhe shokut është i lartë dhe shumë i lartë, p.sh. për mjete matëset e montuar direkt në makina, shirita transportues, etj

- (b) Në lidhje me mjediset mekanike do të konsiderohen sasitë ndikuese të mëposhtme:

- dridhjet;
- shoku mekanik.

- 1.3.3.(a) Mjediset elektromagnetike klasifikohen në klasat E1, E2 ose E3 si përshkruhen më poshtë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në shtojcat specifike të mjetit matës përkatës.

E1	Kjo klasë aplikohet te mjetet matëse të përdorura në vende me çrregullime elektromagnetike që korrespondojnë me ato që mund të gjenden në ndërtesa banesore, komerciale dhe të industrisë së lehtë.
E2	Kjo klasë aplikohet te mjetet matëse të përdorura në vende me çrregullime elektromagnetike që korrespondojnë me ato që mund të gjenden në ndërtesa të tjera industriale.
E3	Kjo klasë aplikohet te mjetet matëse që furnizohen nga bateria e një automjeti. Mjete matëset e tilla duhet të jenë në përputhje me kërkesat e E2-it dhe kërkesat shtesë që vijnë: — ulja e tensionit e shkaktuar nga energjia e qarqeve të ndezjes së motorit me djegie të brendshme, — hedhja përkohësisht e ngarkesës që ndodh në rastin kur një bateri e shkarkuar — është shkyçur, ndërsa motori është i ndezur.

(b) Në lidhje me mjediset elektromagnetike do të konsiderohen sasi të ndikuese të mëposhtme:

- ndërprerjet e tensionit;
- reduktimet e tensionit të shkurtër;
- tension i përkohshëm në linjat e furnizimit dhe / ose linjat sinjalizuese;
- shkarkimet e elektrostatische;
- fushat elektromagnetike të frekuencave të radios;
- përcjellja e fushave elektromagnetike të frekuencave të radios në linjat e furnizimit dhe / ose linjat sinjalizuese;
- valë e madhe në linjat e furnizimit dhe / ose linjat sinjalizuese

1.3.4. Sasi të tjera ndikuese që do të konsiderohen, sipas rastit, janë:

- ndryshimi i tensionit;
- ndryshimi frekuencave kryesore;
- frekuenca e fuqisë së fushave magnetike;
- çdo sasi tjetër që ka gjasa të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në saktësinë e mjetit matës.

1.4. Gjatë kryerjes së testeve siç parashikohen në këtë Rregullore, duhet të aplikohen pikat e mëposhtme:

1.4.1. Rregullat themelore për testime dhe përcaktimin e gabimeve

Kërkesat thelbësore të përcaktuara në pikat 1.1 dhe 1.2 duhet të verifikohen për çdo sasi përkatëse të ndikimit. Përveç nëse specifikohet ndryshe në shtojcën specifike të mjetit matës përkatës, këto kërkesa thelbësore zbatohen kur çdo sasi ndikuese është aplikuar dhe efekti i tij vlerësohet veç e veç, të gjitha sasi të tjera ndikuese mbahen relativisht konstante në vlerën e tyre të referencës.

Testet metrologjike duhet të kryhen gjatë ose pas aplikimit të sasisë ndikuese, cilido kusht që korrespondon me statusin normal funksional të mjetit matës kur sasia e ndikimit ka gjasa të ndodhë.

1.4.2. Lagështira e ambientit

- (a) Sipas mjedisit klimatik funksional në të cilën mjeti matës do të përdoret në gjendje të nxehtësisë së qëndrueshme të pakondensuar ose nxehtësisë e pa kondensuar ciklike (e kondensuar), testi mund të jetë i përshtatshëm.
- (b) Testi i nxehtësisë kondensuar ciklike është i përshtatshëm kur kondensimi është i rëndësishëm ose kur depërtimi i avullit do të përshpejtohet nga efekti i frymëmarrjes. Në kushtet kur lagështira e pa kondensuar është një faktor, është e përshtatshme gjendja e qëndrueshme e nxehtësisë së pa kondensuar.

2. Ri-prodhueshmëria

Zbatimi i të njëjtës sasi të matjes në një vend tjetër ose nga një përdorues tjetër, të gjitha kushtet e tjera janë të njëjta, duhet të rezultojë në marrëveshjen e ngushtë të matjeve të njëpasnjëshme. Dallimi në mes të rezultateve të matjes duhet të jetë i vogël, kur krahasohet me MPE.

3. Përsëritja

Zbatimi i të njëjtës sasi të matjes në kushte të njëjta të matjes do të rezultojë në marrëveshjen e ngushtë të matjeve të njëpasnjëshme. Dallimi në mes të rezultateve të matjes do të jetë i vogël, kur krahasohet me MPE.

4. Diskriminimi dhe ndjeshmëria

Një mjet matës duhet të jetë mjaft i ndjeshëm dhe pragu i diskriminimit duhet të jetë mjaft i ulët për detyrën e matjes së caktuar.

5. Qëndrueshmëria

Një mjet matës duhet të jetë i dizajnuar për të mbajtur një stabilitet të duhur të karakteristikave të tij metrologjike për një periudhë kohore të vlerësuar nga prodhuesi, me kusht që ai është instaluar siç duhet, i mirëmbajtur dhe i përdorur sipas udhëzimeve të prodhuesit, kur ndodhet në kushtet mjedisore për të cilat është paramenduar.

6. Besueshmëria

Një mjet matës duhet të jetë i dizajnuar në atë mënyrë që të zvogëloj sa më shumë të jetë e mundur efektin e një defekti që do të çojë në një rezultat të pasaktë të matjes, përveç nëse prania e një defekti të tillë është e dukshme.

7. Përshtatshmëria

- 7.1. Një mjet matës nuk duhet të ketë ndonjë karakteristikë me gjasa për të lehtësuar përdorimin e mashtrimit, ndërsa mundësitë për keqpërdorime të paqëllimshme duhet të jenë minimale.
- 7.2. Një mjet matës duhet të jetë i përshtatshëm për përdorimin e synuar duke marrë parasysh kushtet praktike të punës dhe nuk duhet të përfshijë kërkesa të paarsyeshme nga përdoruesi në mënyrë që të marrë një rezultat të saktë të matjes.
- 7.3. Gabimet e një mjeti matës të shërbimeve në rrjedhat apo rrymat jashtë kontrollit nuk duhet të ndikohet njëanshëm padrejtësisht.
- 7.4. Kur një mjet matës është projektuar për matjen e vlerave të sasisë së matjes që janë konstante me kalimin e kohës, mjeti matës duhet të jetë i pandjeshëm ndaj luhatjeve të vogla të vlerës së sasisë së matjes, ose duhet të ndërmarrë veprimet e duhura.
- 7.5. Një mjet matës duhet të jetë i fuqishëm dhe materialet e tij të ndërtimit duhet të jenë të përshtatshme për kushtet në të cilat ai synohet të përdoret.
- 7.6. Një mjet matës duhet të jetë i dizajnuar në mënyrë që të lejojë kontrollin e detyrave matëse pasi mjeti matës është vendosur në treg dhe është vënë në përdorim. Nëse është e nevojshme, një pajisje e veçantë ose softuer për këtë kontroll, duhet të jenë pjesë e mjetit matës. Procedura e testit duhet të përshkruhet në manualin e funksionimit.

Kur një mjet matës shoqërohet nga një softuer i cili ofron funksione të tjera përveç funksionit matës, softueri që është kritik për karakteristikat metrologjike duhet të jetë i qartë dhe nuk duhet të ndikohet në mënyrë të papranueshme nga softueri shtesë.

8. Mbrojtja kundër korrupsionit

- 8.1. Karakteristikat metrologjike të një mjeti matës nuk duhet të ndikohen në asnjë mënyrë të papranueshme nga lidhja me të e një pajisje tjetër, nga çdo tipar i pajisjes së lidhur ose me ndonjë pajisje të ndarë që komunikon me mjetin matës.
- 8.2. Një komponent harduer që është kritik për karakteristikat metrologjike duhet të dizajnohet në mënyrë që të jetë i sigurt. Masat e sigurisë të parapara duhet të sigurojnë dëshmi për një ndërhyrje.
- 8.3. Softueri që është kritik për karakteristikat metrologjike duhet të identifikohet si i tillë dhe të sigurohet.

Identifikimi i softuerit duhet të sigurohet lehtësisht nga mjeti matës.

Dëshmia e një ndërhyrje duhet të jetë në dispozicion për një periudhë të arsyeshme kohore.
- 8.4. Të dhënat e matjes, softueri që është kritik për karakteristikat e matjes dhe parametrat metrologjikisht të rëndësishme të ruajtura ose të transmetuara duhet të mbrohen në mënyrë adekuate kundër korrupsionit aksidental apo të qëllimshëm.
- 8.5. Për mjetin matës të shërbimeve komunale paraqitja e totalit të sasisë së furnizuar ose ekranet nga ku mund të shihet sasia totale e furnizimit, referenca e plotë ose e pjesshme të cilat janë bazë për pagesë, nuk duhet të jenë në gjendje që të mbivendosen gjatë përdorimit.

9. Informacioni që duhet të bartet dhe shoqëron mjetin matës

9.1. Një mjet matës duhet të mbaj mbishkrimet e mëposhtme:

(a) emrin e prodhuesit, emrin tregtar të regjistruar ose markën tregtare të regjistruar;

(b) informacion në lidhje me saktësinë e tij;

dhe, sipas nevojës:

(c) informacioni në lidhje me gjendjen e përdorimit;

(d) kapacitetin e matjes;

(e) gamën e matjes;

(f) shënimin e identitetit;

(g) numrin e certifikatës të ekzaminimit të tipit të BE-së ose certifikatën e ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së;

(h) informacioni nëse ka apo jo pajisje të tjera që ofrojnë rezultate metrologjike në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore mbi kontrollin ligjor metrologjik.

9.2. Një mjet matës i dimensioneve shumë të vogla ose shumë të ndjeshme të përbërjes e lejon atë që të mbajë informacione të rëndësishme, duhet të ketë paketimin e tij, dhe nëse ka, edhe dokumentet shoqëruese të përcaktuara nga dispozitat e kësaj Rregullore të shënuar në mënyrë të përshtatshme.

9.3. Mjeti matës duhet të shoqërohet me informacione për funksionimin e tij, përveç nëse thjeshtësia e mjetit matës e bën atë të panevojshme. Informacioni duhet të jetë lehtësisht i kuptueshëm dhe duhet të përfshijë, sipas rastit:

(a) kushtet e vlerësuara funksionale;

(b) klasat e mjedisit mekanik dhe elektromagnetik;

(c) kufiri i lartë dhe i ulët i temperaturës, nëse kondensimi është i mundur apo jo, vende të hapura ose të mbyllura;

(d) udhëzimet për instalimin, mirëmbajtjen, riparimin, rregullime të lejueshme;

(e) udhëzime për funksionimin e duhur dhe kushtet e veçanta të përdorimit;

(f) kushtet për pajtueshmërinë me ndërfaqet (interface), nën-montimet ose mjete matëset matëse.

- 9.4. Grupet e mjete matëseve matëse identike që përdoren në të njëjtin vend ose që përdoren për matjet e shërbimeve komunale nuk është e thënë të pajisen me manuale individuale udhëzuese.
- 9.5. Përveç nëse specifikohet ndryshe në një shtojcë specifike të mjetit matës përkatës, intervali i shkallës për një vlerë të matur, duhet të jetë në formën $1 \times 10n$, $2 \times 10n$, or $5 \times 10n$, ku n është numër i plotë ose zero. Njësia e matjes apo simboli i saj duhet të tregohet afër vlerës numerike.
- 9.6. Një masë materiale, duhet të shënohet me një vlerë nominale ose një shkallë, e shoqëruar nga njësia e matjes së përdorur.
- 9.7. Njësitë e matjes të përdorura dhe simbolet e tyre duhet të jetë në përputhje me dispozitat e legjislacionit të BE-së për njësitë e matjes dhe simbolet e tyre.
- 9.8. Të gjitha markat dhe mbishkrimet e nevojshme sipas çdo kërkesë duhet të jenë të qarta, të pashlyeshme, të kuptueshme dhe jo të lëvizshme.

10. Paraqitja e rezultatit

- 10.1. Paraqitja e rezultatit do të bëhet në ekran ose në kopje fizike.
- 10.2. Paraqitja e rezultatit duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme dhe e shoqëruar me markat dhe mbishkrimet e nevojshme për të informuar përdoruesit për rëndësinë e rezultatit. Duhet të lejohet leximi i lehtë i rezultatit të paraqitur, në kushte normale të përdorimit. Indikacione shitesë mund të shfaqen me kusht që ata nuk mund të ngatërrohen me indikacionet e kontrolluara metrologjikisht.
- 10.3. Në rast të kopjes fizike, kopja e shtypur ose të dhënat duhet të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të pashlyeshme.
- 10.4. Një mjet matës i transaksioneve të shitjes tregtare direkt duhet të dizajnohen për të paraqitur rezultatin e matjes për të dy palët në transaksion kur është e instaluar, ashtu si synohet. Kur është kritike, sa i përket shitjes direkt, çdo biletë e ofruar për konsumatorin nga një pajisje ndihmëse që nuk vepron në përputhje me kërkesat përkatëse të kësaj Rregullore duhet të mbajnë informacionin e duhur kufizues.
- 10.5. Një mjet matës i destinuar për qëllime të matjes së shërbimeve komunale mund ose jo të lexohet nga distanca, duhet në çdo rast të jetë i pajisur me një ekran të kontrolluar metrologjikisht pa qasje për konsumatorin. Shqyrtimi i këtij ekrani është rezultati i matjes që shërben si bazë për çmimin që duhet të paguaj.

11. Shqyrtimi i mëtëjshëm i të dhënave për të përfunduar transaksionin tregtar

- 11.1. Një mjet matës përveç mjetit matës për matjen e shërbimeve komunale duhet të regjistroj me mjete të qëndrueshme rezultatin e matjes të shoqëruar me informacionin për të identifikuar transaksionin e veçantë, kur:
- (a) matja nuk përsëritet; dhe

(b) mjeti matës matës është zakonisht i destinuar për përdorim në mungesë të njërës prej palës tregtare.

11.2. Përveç kësaj, një dëshmi e qëndrueshme e rezultatit të matjes dhe informacioni për identifikimin e transaksionit duhet të jetë në dispozicion në kohën kur matja ka përfunduar.

12. Vlerësimi i konformitetit

Një mjet matës duhet të jetë i dizajnuar në mënyrë që të lejojë vlerësimin e gatshëm të konformitetit të tij me kërkesat përkatëse të kësaj Rregullore.

SHTOJCA II

MODULI A: KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT

1. ‘Kontrolli i brendshëm i prodhimit’ është procedura e vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi plotëson detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 dhe siguron e deklaron vetëm në përgjegjësinë e tij që mjete matëset në fjalë, janë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore për të cilat ajo zbatohet.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të përgatis dokumentacionin teknik ashtu si përshkruhet në nenin 18. Dokumentacioni duhet të mundësoj vlerësimin e përputhshmërisë së mjetit matës me kërkesat përkatëse, dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm së rrezikut (rreziqeve). Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e aplikueshme dhe të mbuloj, në mënyrën më të përshtatshme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e mjetit matës.

3. Prodhimi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë përputhshmërinë e mjete matëseve të prodhuara me dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 2 dhe me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

4. Shënjimi i konformitetit dhe deklaratat e konformitetit e BE-së

- 4.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE dhe shenjë shtesë të metrologjisë, të përcaktuar në këtë Rregullore për secilin mjet matës individualisht, që plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.
- 4.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE-së për çdo model të mjetit matës dhe së bashku me dokumentacionin teknik ta mbaj atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse te një përdorues i vetëm.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që këto të specifikohen në një urdhëresë.

MODULI A2: KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT PLUS KONTROLLET E MBIKËQYRURA TË MJETEVE MATËSE NË INTERVALE RASTËSORE

1. Kontrolli i brendshëm i prodhimit plus kontrollet e mbikëqyrura të mjeteve matëse është procedura e vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi plotëson detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5 dhe siguron e deklaron vetëm në përgjegjësinë e tij që mjetet matëse në fjalë, janë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore për të cilat ajo zbatohet.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të përgatis dokumentacionin teknik ashtu si përshkruhet në nenin 18. Dokumentacioni duhet të mundësoj vlerësimin e përputhshmërisë së

mjetit matës me kërkesat përkatëse, dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm së rrezikut (rreziqeve). Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e aplikueshme dhe të mbuloj, në mënyrën më të përshtatshme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e mjetit matës.

3. Prodhimi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë përputhshmërinë e mjeteve matëse të prodhuara me dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 2 dhe me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

4. Kontrollat e mjeteve matëse

Varësisht nga zgjedhja e prodhuesit, një trup i akredituar i brendshëm apo një trup i notifikuar, të zgjedhur nga prodhuesi, do të kryejë kontrolle të mjetit matës ose i kanë kryer ato në intervale rastësore të përcaktuara nga trupi, për të verifikuar cilësinë e kontrolleve të brendshme të mjetit matës, duke marrë parasysh, ndër të tjera, kompleksitetin teknologjik të mjeteve matëse dhe sasinë e prodhimit. Duhet të shqyrtohet një mostër e përshtatshme e mjeteve matëse finale, të marra në vend nga trupi para vendosjes në treg, testet e duhura të identikuara nga pjesët përkatëse të standardit të harmonizuar, dhe / ose dokumenti normativ, dhe / ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike përkatëse, do të kryhen për të verifikuar konformitetin e mjeteve matëse me kërkesat përkatëse të kësaj Rregullore. Në mungesë të një standardi përkatës të harmonizuar ose dokumenti normativ, trupi i akredituar i brendshëm ose trupi i autorizuar në fjalë do të vendosë për kryerjen e testeve të duhura.

Në ato raste kur një numër i madh i mjeteve matëse në mostër nuk përputhen me nivelin e pranueshëm të cilësisë, trupi i akredituar i brendshëm ose trupi i notifikuar duhet të marr masat e duhura.

Atëherë kur testet kryhen nga një trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit, prodhuesi, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar, do të vendosë numrin e identifikimit të trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit gjatë procesit të prodhimit.

5. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit të BE-së

- 5.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE dhe shenjë shtesë të metrologjisë, të përcaktuar në këtë Rregullore për secilin mjet matës individualisht, që plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.
- 5.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE-së për çdo model të mjetit matës dhe së bashku me dokumentacionin teknik ta mbaj atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit të BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse të një përdoruesi të vetëm.

6. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 5 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që këto të specifikohen në një urdhëresë.

MODULI B: EKZAMINIMI I TIPIT-BE

1. 'Ekzaminimi i tipit-BE' është pjesë e një procedure të vlerësimit të konformitetit ku një trup i notifikuar shqyrton dizajnin teknik të një mjeti matës dhe verifikon e vërteton se projekti teknik i mjetit matës plotëson kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për të.

2. Ekzaminimi i tipit-BE mund të bëhet në ndonjërin nga mënyrat e mëposhtme:

- (a) shqyrtimi i një mostre, që është pjesë e prodhimit të parashikuar e mjetit mates të plotë (llojit të prodhimit),
- (b) vlerësimi i mjaftueshmërisë së projektimit teknik të mjetit matës nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe dëshmive mbështetëse të përmendura në pikën 3, plus ekzaminimin e mostrave, pjesë e prodhimit të parashikuar të një ose më shumë pjesëve kritike të mjetit matës (kombinim i llojit të prodhimit dhe llojit të projektimit);
- (c) vlerësimin e mjaftueshmërisë së projektimit teknik të mjetit matës nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe dëshmive mbështetëse të përmendura në pikën 3, pa shqyrtimin e një mostre (lloji i projektimit).

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit vendos për mënyrën e duhur dhe mostrat e kërkuara.

3. Prodhuesi duhet të parashtojë një kërkesë për ekzaminimin e tipit- BE me një trup të notifikuar të zgjedhur prej tij.

Aplikimi duhet të përfshijë:

- (a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e tij;
- (b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë tjetër trup i notifikuar;
- (c) dokumentacionin teknik si përshkruhet në nenin 18. Dokumentacioni teknik duhet të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit të mjetit matës me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore dhe duhet të përfshijë një analizë adekuate si dhe vlerësimin e rrezikut (rreziqeve). Dokumentacioni teknik duhet të specifikojë kërkesat e aplikueshme dhe do të mbulojë në mënyrën më të përshtatshme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e mjetit matës.

Kërkesa duhet të përmbajë përveç kësaj, kudo ku është e aplikueshme edhe:

- (d) mostrat, që është pjesë e prodhimit të parashikuar. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të kërkojë mostra të tjera nëse janë të nevojshme për kryerjen e programit të testimit;
- (e) dëshmi mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes teknike të projektimit. Kjo dëshmi mbështetëse duhet të paraqes të gjitha dokumentet që janë përdorur, veçanërisht në rastet e standardeve përkatëse të harmonizuara, dhe / ose kur dokumentet normative nuk janë aplikuar në mënyrë të plotë. Dëshmitë mbështetëse duhet të përfshijnë, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera në përputhje me specifikimet e tjera teknike përkatëse nga laboratorit i caktuar i prodhuesit, ose nga një tjetër laborator testimi në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

4. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit:

Për mjetin matës do të:

4.1. shqyrtojë dokumentacionin teknik dhe dëshmitë mbështetëse për të vlerësuar përshtatshmërinë e projektimit teknik të mjetit matës;

Për mostrën/mostrat do të:

4.2. verifikojë nëse mostra/t janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe të identifikojnë elementet të cilat janë të dizajnuara në përputhje me dispozitat e aplikueshme të standardeve përkatëse të harmonizuara dhe / ose dokumentet normative, si dhe elementet të cilat janë projektuar në përputhje me specifikimet tjera teknike përkatëse;

4.3. të kryej ekzaminimet dhe testet e duhura, ose që janë kryer, për të kontrolluar nëse prodhuesi ka zgjedhur të zbatojë zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara dhe dokumentet normative, ato janë zbatuar drejt;

4.4. të kryej ekzaminimet dhe testet e duhura, ose që janë kryer, për të kontrolluar nëse, në rastet e zgjidhjes në standardet përkatëse të harmonizuara, dhe / ose dokumentet normative nuk janë zbatuar, zgjidhjet e adoptuara nga prodhuesi për të aplikuar specifikimet e tjera relevante teknike plotësojnë kërkesat thelbësore përkatëse të kësaj Rregullore;

4.5. të bie dakord me prodhuesin për vendin se ku do të kryhen ekzaminimet dhe testet.

Për pjesët e tjera të mjetit matës do të:

4.6. shqyrtojë dokumentacionin teknik dhe dëshmitë mbështetëse për të vlerësuar përshtatshmërinë e projektimit teknik të pjesëve të tjera të mjetit matës.

5. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të hartojë një raport vlerësimi ku regjistrohen aktivitetet e ndërmarra në pajtim me pikën 4 dhe rezultatet e tyre. Pa cenuar detyrimet e saj vis-à-vis, autoritetet notifikuese, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të nxjerrë përmbajtjen e atij raporti, në tërësi ose pjesërisht, vetëm me pajtimin e prodhuesit.

6. Kur tipi i plotëson kërkesat e kësaj Rregullore, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit nxjerr një certifikatë të ekzaminimit të tipit-BE për prodhuesin. Kjo certifikatë duhet të përmbajë emrin dhe adresën e prodhuesit, konkluzionet e ekzaminimit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e saj dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e llojit të miratuar. Certifikata e ekzaminimit të tipit-BE mund të ketë një ose më shumë shtojca të bashkangjitura.

Certifikata e ekzaminimit të tipit-BE dhe shtojcat e saj duhet të përmbajnë të gjitha informatat relevante për të lejuar konformitetin e mjeteve matëse të prodhuara me llojin e ekzaminuar për të vlerësuar dhe për të lejuar kontrollin në vendin e punës. Në veçanti, për të lejuar konformitetin e mjeteve matëse të prodhuara të vlerësohen me llojin e ekzaminuar lidhur me riprodhueshmërinë e ecurive të tyre metrologjike, kur ato janë të përshtatura siç duhet duke përdorur mjetet e duhura, përmbajtja duhet të përfshijë:

— karakteristikat metrologjike të llojit të mjetit matës;

— masat e nevojshme për të siguruar integritetin e mjeteve matëse (vulosja, identifikimi i softuerit, etj);

— informacionin për elementet e tjera të nevojshme për identifikimin e mjeteve matëse dhe për të kontrolluar konformitetin e tyre vizual të jashtëm me atë të llojit;

— nëse është e përshtatshme, çdo informacion specifik i nevojshëm për të verifikuar karakteristikat e mjeteve matëse të prodhuara;

— në rastin e një nën-montimi, të gjithë informacionin e nevojshëm për të siguruar pajtueshmërinë me nën-sistemet e tjera ose mjetet matëse.

Certifikata e ekzaminimit të tipit-BE do të jetë valide për 10 vjet nga data e lëshimit të saj, dhe mund të rinovohet për periudha pasuese prej 10 vjet secila.

Atëher kur tipi nuk i përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit refuzon të lëshojë një certifikatë të ekzaminimit të tipit-BE dhe do të informoj aplikuesin respektiv duke i dhënë arsyt e hollësishme për refuzimin e saj

7. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të jetë i informuar për çdo ndryshim në gjendjen aktuale përgjithësisht të pranuar të cilat tregojnë se tipi i miratuar nuk përputhet më me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, dhe do të përcaktojë nëse ndryshimet e tilla kërkojnë hetime të mëtejshme. Nëse është kështu, trupi i notifikuar do të informoj prodhuesit në përputhje me rrethanat.
8. Prodhuesi duhet të informojë trupin e notifikuar që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën e ekzaminimit të tipit-BE për të gjitha ndryshimet në llojin e miratuar që mund të ndikojnë në konformitetin e mjetit matës me kërkesat thelbësore të kësaj Rregullore ose kushtet për vlefshmërinë e certifikatës. Ndryshimet e tilla do të kërkojnë miratim shtesë në formën e një shtese në certifikatën origjinale të ekzaminimit të tipit-BE.
9. Çdo trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informojë AMK-në në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të tipit-BE dhe / ose ndonjë shtesë të saj që i janë shtuar apo tërhequr, dhe periodikisht ose në bazë të kërkesës, do të vendos në dispozicion të AMK-së listën e certifikatave të tilla dhe / ose çdo shtesë të refuzimit, pezullimit ose përndryshe të kufizimit.

Komisioni Evropian, dhe trupat tjerë të autorizuar për vlerësim të konformitetit sipas kërkesës, mund të pajisen me një kopje të certifikatave të ekzaminimit të tipit-BE dhe/ose pjesët shtesë të saj. Sipas kërkesës, Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare mund të pajisen me një kopje të dokumentacionit teknik dhe rezultatet e ekzaminimeve të kryera nga trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit.

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të ruaj një kopje të certifikatës së ekzaminimit të tipit-BE, shtojcat e saj dhe shtesat, si dhe dosjen teknike duke përfshirë dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi deri në skadimin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.

10. Prodhuesi duhet të ruaj një kopje të certifikatës së ekzaminimit të tipit-BE, shtojcat e saj dhe shtesat së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi mjeti matës është vendosur në treg.
11. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqes aplikimin e përmendur në pikën 3 dhe të përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikat 8 dhe 10, me kusht që ato janë të specifikuara në një urdhëresë.

MODULI C: KONFORMITETI SIPAS TIPIT I BAZUAR NË KONTROLLIN E BRENDSHËM TË PRODHIMIT

1. Kontrolli sipas llojit i bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi plotëson detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 dhe siguron e deklaron se mjetet matëse në fjalë janë në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipit-BE dhe është përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore për të cilat ajo zbatohet.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë përputhshmërinë e mjeteve matëse të prodhuara me dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 2 dhe me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

3. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit të BE-së

- 3.1 Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE dhe shenjë shtesë të metrologjisë, të përcaktuar në këtë Rregullore për secilin mjet matës individualisht, që plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

- 3.2 Prodhuksi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE-së për çdo model të mjetit matës dhe së bashku me dokumentacionin teknik ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit të BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse të një përdoruesi të vetëm.

4. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 5 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që këto të specifikohen në një urdhëresë.

MODULI C2: KONFORMITETI I TIPIT I BAZUAR NË KONTROLLIN E BRENDSHËM TË PRODHIMIT PLUS KONTROLLE TË MBIKËQYRURA TË MJETIT MATËS NË INTERVALE TË RASTËSISHME

1. Kontrolli sipas tipit i bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të konformitetit me të cilën prodhuesi plotëson detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 dhe 4 siguron e deklaron se mjetet matëse në fjalë janë në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipit-BE dhe është në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore për të cilat ajo zbatohet.

2. Prodhimi

Prodhuksi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e mjeteve matëse të prodhuara me tipin e përshkruar në certifikatën për shqyrtimin e BE-së, dhe me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për këto mjete matëse.

Kontrollet e mjetit matës

3. Sipas zgjedhjes së prodhuesit, qoftë një trup i brendshëm i akredituar apo një trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, duhet të kryejë kontrollet e mjetit matës në intervale të rastësishme të përcaktuara nga trupi, në mënyrë që të verifikohet cilësia e kontrolleve të brendshme të mjetit matës, duke marrë parasysh, mes tjerash, kompleksitetin teknologjik të mjeteve matëse dhe të sasisë së prodhimit. Një mostër e përshtatshme e mjetit matës përfundimtar, e marrur, para vendosjes në treg, nga një vend i caktuar nga trupi i brendshëm i akredituar ose nga trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, duhet të shqyrtohet, dhe testet e duhura siç identifikohet nga pjesët relevante të standardeve të harmonizuara, dhe / ose dokumentet normative, dhe / ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet tjera teknike relevante, duhet të kryhen për të verifikuar konformitetin e mjetit matës me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipit-BE dhe me kërkesat relevante të kësaj Rregullore.

Kur një mostër nuk përputhet me një nivel të pranueshëm të kualitetit, trupi i brendshëm i akredituar ose trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të marrë masat e duhura.

Procedura e pranimi të mostrave që duhen zbatuar ka për qëllim të përcaktojë nëse procesi i prodhimit të mjetit matës kryhet brenda kufijve të pranueshëm, me synimin e sigurimit të konformitetit të mjetit matës.

Kur testet kryen nga një trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit, prodhuesi, nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit, duhet të vendosë numrin identifikues të trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit gjatë procesit të prodhimit.

4. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

- 4.1. Prodhuesi duhet të vendosë shënjimin CE dhe shënjimin plotësues të metrologjisë të përcaktuar në këtë Rregullore, tek secili mjet matës individual që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e tipit-BE dhe përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.
- 4.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE-së për çdo model të mjetit matës dhe së bashku me dokumentacionin teknik ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse të një përdoruesi të vetëm.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që këto të specifikohen në një urdhëresë.

MODULI D: KONFORMITETI I TIPIT I BAZUAR NË SIGURIMIN E CILËSISË SË PROCESIT TË PRODHIMIT

1. Konformiteti i tipit i bazuar në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit është pjesë e një procedure të vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi plotëson detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi se mjetet matëse në fjalë janë në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e tipit-BE dhe përmbush kërkesat e kësaj Rregullore që kanë lidhje me këto mjete matëse.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të operojë një sistem të cilësisë të aprovuar për prodhimin, inspektim i produktit final dhe testim të mjeteve matëse në fjalë, siç është specifikuar në pikën 3 dhe duhet t'i nënshtrohet mbikëqyrjes, siç është specifikuar në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

- 3.1 Prodhuesi, përmes një trupi të autorizuar për vlerësim të konformitetit të zgjedhur nga ai, duhet të paraqes një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për mjetet matëse në fjalë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

- (a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar,
- (b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë tjetër trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit,
- (c) të gjitha informacionet relevante të parashikuara për kategorinë e mjetit matës;
- (d) dokumentacioni në lidhje me sistemin e cilësisë;
- (e) dokumentacioni teknik i tipit të miratuar dhe një kopje e certifikatës për ekzaminimin e tipit- BE.

3.2 Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë se mjetet matëse janë në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e për ekzaminimin e tipit-BE dhe në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për këto mjete matëse.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e pranuar nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave lidhur me cilësinë.

Duhet të përmbajë, në veçanti, një përshkrim të duhur të:

- (f) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhmentit në lidhje me cilësinë e produktit;
- (g) prodhimit përkatës, teknikave të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike të cilat do të përdoren;
- (h) ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, dhe shpeshtësisë me të cilën mendohet të kryhen;
- (i) të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë;
- (j) mjeteve të monitorimit të arriturave të cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3 Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2.

Duhet të supozojë konformitetin me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që janë në pajtim me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar relevant.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë në vlerësim në fushën e mjetit matës relevant dhe teknologjisë së mjetit matës, dhe me njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi do të përfshijë një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit.

Ekipi i auditimit duhet të shqyrtojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 3.1(e), në mënyrë që të verifikojë aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat relevante të kësaj Rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë së mjetit matës me këto kërkesa.

Vendimi duhet t'i njoftohet prodhuesit. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e auditimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuksi duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta ruajë atë, në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas

3.5 Prodhuksi duhet ta mbajë trupin e notifikuar që e ka miratuar sistemin e cilësisë të informuar për çdo ndryshim të planifikuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i modifikuar do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar

4.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është për t'u siguruar që prodhuksi përmbush në mënyrën e duhur detyrimet që dalin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2. Për qëllime të vlerësimit, prodhuksi duhet t'i lejojë trupit të autorizuar qasje në prodhim, inspektim, testim dhe vendet e magazinimit dhe t'i ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

(a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

(b) të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë.

4.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të kryejë auditime periodike për të siguruar që prodhuksi ruan dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i ofrojë prodhuesit një raport të auditimit.

4.4. Përveç kësaj, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të bëjë vizita të pa paralajmëruara tek prodhuksi. Gjatë vizitave të tilla trupi i notifikua trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, nëse është e nevojshme, mund të bëjë teste të produktit për të verifikuar që sistemi i cilësisë është duke funksionuar në mënyrën e duhur. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet t'i ofrojë prodhuesit raportin e vizitës dhe, në qoftë se janë bërë testimet, me raportin e testimit.

5. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit sipas BE-së

5.1. Prodhuksi duhet të vendosë shenjën CE dhe shenjën plotësues të metrologjisë, të përcaktuar në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar të referuar në pikën 3.1, numrin e identifikimit këtij të fundit për secilin mjet matës individual që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e tipit-BE dhe përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

5.2. Prodhuksi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit të BE-së për çdo model të mjetit matës dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit të BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit të BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse të një përdoruesi të vetëm.

6. Prodhuksi duhet, për periudhën pas 10 viteve pasi që mjeti matës është vendosur në treg, të mbajë ato në dispozicion për autoritetet kombëtare:

- a) dokumentacionin e referuar në pikën 3.1,
 - b) informacionin në lidhje me ndryshimin të referuar në pikën 3.5, ashtu siç është miratuar;
 - c) vendimet dhe raportet e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.
7. Çdo trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informojë AMK-në për miratimet e lëshuara apo të anuluar të sistemit të cilësisë, dhe duhet të vë në dispozicion për AMK-në, periodikisht ose në bazë të kërkesës, listën e miratimeve të refuzuara, pezulluara ose kufizuara të sistemit të cilësisë.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë të specifikuara në mandat.

MODULI D1: SIGURIMI I CILËSISË SË PROCESIT TË PRODHIMIT

1. Sigurimi i cilësisë së procesit të prodhimit është procedura e vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi plotëson detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 4 dhe 7, dhe siguron dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij që mjetet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e kësaj Rregullore, që zbatohen tek këto mjete matëse.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të përgatis dokumentacionin teknik ashtu si përshkruhet në nenin 18. Dokumentacioni duhet të mundësoj vlerësimin e përputhshmërisë së mjetit matës me kërkesat përkatëse, dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm së rrezikut (rreziqeve). Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e aplikueshme dhe të mbuloj, në mënyrën më të përshtatshme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e mjetit matës.

3. Prodhuesi duhet të mbaj dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve relevante kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

4. Prodhimi

Prodhuesi duhet të operojë një sistem të miratuar të cilësisë për prodhim, inspektim të produktit final dhe testim të mjeteve matëse në fjalë, siç është specifikuar në pikën 5, dhe duhet të mbikëqyr, siç është specifikuar në pikën 6.

5. Sistemi i cilësisë

- 5.1. Prodhuesi, përmes një trupi të notifikuar të zgjedhur nga ai, duhet të paraqes një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për mjetet matëse në fjalë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

- (a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar;
- (b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë tjetër trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit;

- (c) të gjitha informacionet relevante të parashikuara për kategorinë e mjetit matës;
- (d) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;
- (e) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 2.

5.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhjen e mjeteve matëse me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për këto mjete matëse.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e pranuar nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave lidhur me cilësinë.

Duhet të përmbajë, në veçanti, një përshkrim të duhur të:

- (a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhmentit në lidhje me cilësinë e produktit;
- (b) prodhimit përkatës, teknikave të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike të cilat do të përdoren;
- (c) ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, dhe shpeshësisë me të cilën mendohet të kryhen;
- (d) të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë;
- (e) mjeteve të monitorimit të arritjes së cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

5.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e referuara në pikën 5.2.

Duhet të supozojë konformitetin me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që janë në pajtim me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar relevant.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë në vlerësim në fushën e mjetit matës relevant dhe teknologjisë së mjetit matës, dhe me njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi do të përfshijë një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit.

Ekipi i auditimit duhet të shqyrtojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 3.1(e), në mënyrë që të verifikojë aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat relevante të kësaj Rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë së mjetit matës me këto kërkesa. Vendimi duhet t'i njoftohet prodhuesit. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e auditimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

5.4. Prodhuesi duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta ruajë atë, në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.

5.5. Prodhuesi duhet ta mbajë trupin e notifikuar që e ka miratuar sistemin e cilësisë të informuar për çdo ndryshim të planifikuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i notifikuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendos nëse sistemi i cilësisë i modifikuar do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

6. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit

- 6.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është për t'u siguruar që prodhuesi përmbush në mënyrën e duhur detyrimet që dalin nga sistemi i miratuar i cilësisë.
- 6.2. Për qëllime të vlerësimit, prodhuesi duhet t'i lejojë trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit qasje në prodhim, inspektim, testim dhe vendet e magazinimit dhe t'i ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:
- (a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
 - (b) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 2;
 - (c) të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë.
- 6.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të kryejë auditime periodike për të siguruar që prodhuesi ruan dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i ofrojë prodhuesit një raport të auditimit.
- 6.4. Përveç kësaj, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të bëjë vizita të pa paralajmëruara tek prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, nëse është e nevojshme, mund të bëjë teste të produktit për të verifikuar që sistemi i cilësisë është duke funksionuar në mënyrën e duhur. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet t'i ofrojë prodhuesit raportin e vizitës dhe, në qoftë se janë bërë testimet, me raportin e testimit.

7. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

- 7.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjën CE dhe shenjën plotësues të metrologjisë, të përcaktuar në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar të referuar në pikën 5.1, numrin e identifikimit këtij të fundit për secilin mjet matës individual që përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.
- 7.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit e BE-së për çdo model të mjetit matës dhe ta mbaj atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse te një përdorues i vetëm.

8. Prodhuesi duhet, për një periudhë që përfundon 10 vjet pasi që mjeti matës është plasuar në treg, t'i mbajë në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

- (a) dokumentacionin e referuar në pikën 5.1,
- (b) informacionin në lidhje me ndryshimin të referuar në pikën 5.5, ashtu siç është miratuar;
- (c) vendimet dhe raportet e trupit të notifikuar të referuar në pikat 5.5, 6.3 dhe 6.4.

9. Çdo trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informojë AMK-në për miratimet e lëshuara apo të anuluar të sistemit të cilësisë, dhe duhet të vë në dispozicion për AMK-në, periodikisht ose në bazë të kërkesës, listën e miratimeve të refuzuara, pezulluara ose kufizuara të sistemit të cilësisë.

10. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3, 5.1, 5.5, 7 dhe 8 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë të specifikuara në mandat.

MODULI E: KONFORMITETI I TIPIT I BAZUAR NË SIGURIMIN E CILËSISË SË PRODUKTIT

1. Konformiteti i tipit bazuar në sigurimin e cilësisë së mjetit matës është pjesë e një procedure të vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi plotëson obligimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5 dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi që mjetet matëse në fjalë, janë në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipit-BE dhe plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen tek këto mjete matëse.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të operojë një sistem cilësie të miratuar për inspektimin produktit final dhe testimin e mjeteve matëse në fjalë, siç është specifikuar në pikën 3 dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes, siç është specifikuar në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

- 3.1. Prodhuesi, përmes një trupi të autorizuar për vlerësim të konformitetit të zgjedhur nga ai, duhet të paraqes një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për mjetet matëse në fjalë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

- (a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar,
- (b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë tjetër trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit,
- (c) të gjitha informacionet relevante të parashikuara për kategorinë e mjetit matës;
- (d) dokumentacioni në lidhje me sistemin e cilësisë;
- (e) dokumentacioni teknik i tipit të miratuar dhe një kopje e certifikatës për ekzaminimin e tipit- BE.

- 3.2 Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë se mjetet matëse janë në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën e për ekzaminimin e tipit-BE dhe në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e pranuar nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave lidhur me cilësinë.

Duhet të përmbajë, në veçanti, një përshkrim të duhur të:

- a. objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhmentit në lidhje me cilësinë e produktit;
- b. ekzaminimet dhe testet që do të kryhen pas prodhimit;
- c. të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë;
- d. mjeteve të monitorimit të operimit efektiv të sistemit të cilësisë

- 3.3 Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e referuara në pikën 3.2.

Duhet të supozojë konformitetin me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që janë në pajtim me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar relevant.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë në vlerësim në fushën e mjetit matës relevant dhe teknologjisë së mjetit matës, dhe me njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi do të përfshijë një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit.

Ekipi i auditimit duhet të shqyrtojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën (e) 3.2, në mënyrë që të verifikojë aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat relevante të kësaj Rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë së mjetit matës me këto kërkesa.

Vendimi duhet t'i njoftohet prodhuesit. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e auditimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta ruajë atë, në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.

3.5 Prodhuesi duhet ta mbajë trupin e autorizuar për vlerësim të konformitetit që e ka miratuar sistemin e cilësisë, të informuar, për çdo ndryshim të planifikuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i modifikuar do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit i autorizuar për vlerësim të konformitetit

4.1 Qëllimi i mbikëqyrjes është për t'u siguruar që prodhuesi përmbush në mënyrën e duhur detyrimet që dalin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Për qëllime të vlerësimit, prodhuesi duhet t'i lejojë trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit qasje në prodhim, inspektim, testim dhe vendet e magazinimit dhe t'i ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë.

5.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të kryejë auditime periodike për të siguruar që prodhuesi ruan dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i ofrojë prodhuesit një raport të auditimit.

5.4. Përveç kësaj, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të bëjë vizita të pa paralajmëruara tek prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, nëse është e nevojshme, mund të bëjë teste të produktit për të verifikuar që sistemi i cilësisë është duke funksionuar në mënyrën e duhur. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet t'i ofrojë prodhuesit raportin e vizitës dhe, në qoftë se janë bërë testimet, me raportin e testimit.

6. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

6.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE dhe shenjë plotësues të metrologjisë, të përcaktuar në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikën 3.1, numrin e identifikimit këtij të fundit për secilin mjet matës individual që është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e tipit-BE dhe përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

6.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit e BE-së për çdo model të mjetit matës dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse te një përdorues i vetëm.

7. Prodhuksi duhet, për periudhën pas 10 viteve pasi që mjeti matës është vendosur në treg, të mbajë ato në dispozicion për autoritetet kombëtare:
 - a) dokumentacionin e referuar në pikën 3.1,
 - b) informacionin në lidhje me ndryshimin të referuar në pikën 3.5, ashtu siç është miratuar;
 - c) vendimet dhe raportet e trupit të notifikuar të referuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.
8. Çdo trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informojë AMK-në për miratimet e lëshuara apo të anuluar të sistemit të cilësisë, dhe duhet të vë në dispozicion për AMK-në, periodikisht ose në bazë të kërkesës, listën e miratimeve të refuzuara, pezulluara ose kufizuara të sistemit të cilësisë.

9. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë të specifikuara në mandat.

MODULI E1: SIGURIMI I CILËSISË SË INSPEKTIMIT DHE TESTIMIT TË MJETIT MATËS FINAL

1. Sigurimi i cilësisë për inspektimin dhe testimin e mjetit matës final është procedura e vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi plotëson detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 4 dhe 7, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi se mjetet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohet për këto mjete matëse.
2. **Dokumentacioni teknik**

Prodhuksi duhet të përgatis dokumentacionin teknik ashtu si përshkruhet në nenin 18. Dokumentacioni duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të mjetit matës me kërkesat përkatëse, dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm së rrezikut (rreziqeve). Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e aplikueshme dhe të mbulojë, në mënyrën më të përshtatshme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e mjetit matës.
3. Prodhuksi duhet të mbajë dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve relevante kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.
4. **Prodhimi**

Prodhuksi duhet të operojë një sistem të miratuar të cilësisë për prodhim, inspektim të produktit final dhe testim të mjeteve matëse në fjalë, siç është specifikuar në pikën 5, dhe duhet të mbikëqyrë siç është specifikuar në pikën 6.

5. Sistemi i cilësisë

- 5.1. Prodhuksi, përmes një trupi të notifikuar të zgjedhur nga ai, duhet të paraqes një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për mjetet matëse në fjalë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

- (a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar,
- (b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë tjetër trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit,
- (c) të gjitha informacionet relevante të parashikuara për kategorinë e mjetit matës;
- (d) dokumentacioni në lidhje me sistemin e cilësisë;
- (e) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 2.

5.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhjen e mjete matëseve matëse me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për këto mjete matëse.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e pranuar nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave lidhur me cilësinë.

Duhet të përmbajë, në veçanti, një përshkrim të duhur të:

- (a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhmentit në lidhje me cilësinë e produktit;
- (b) ekzaminimit dhe testeve që do të kryhen pas prodhimit;
- (c) të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë;
- (d) mjeteve të monitorimit të funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

5.3. Trupi i notifikuar duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i përmbushë kërkesat e referuara në pikën 5.2.

Duhet të supozojë konformitetin me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që janë në pajtim me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar relevant.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë në vlerësim në fushën e mjetit matës relevant dhe teknologjisë së mjetit matës, dhe me njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi do të përfshijë një vizitë vlerësimi në ambientet e prodhuesit.

Ekipi i auditimit duhet të shqyrtojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 2, në mënyrë që të verifikojë aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat relevante të kësaj Rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë së mjetit matës me këto kërkesa.

Vendimi duhet t'i njoftohet prodhuesit. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e auditimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

5.4. Prodhuesi duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta ruajë atë, në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.

5.5. Prodhuesi duhet ta mbajë trupin e notifikuar që e ka miratuar sistemin e cilësisë, të informuar, për çdo ndryshim të planifikuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendos nëse sistemi i cilësisë i modifikuar do të vazhdojë të

përmbush kërkesat e referuara në pikën 5.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

6. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar

6.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është për t'u siguruar që prodhuesi përmbush në mënyrën e duhur detyrimet që dalin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

6.2. Për qëllime të vlerësimit, prodhuesi duhet t'i lejojë trupit të notifikuar qasje në prodhim, inspektim, testim dhe vendet e magazinimit dhe t'i ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

(a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

(b) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 2;

(c) të dhënat mbi cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë.

6.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të kryejë auditime periodike për të siguruar që prodhuesi ruan dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i ofrojë prodhuesit një raport të auditimit.

6.4. Përveç kësaj, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të bëjë vizita të pa paralajmëruara tek prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, nëse është e nevojshme, mund të bëjë teste të produktit për të verifikuar që sistemi i cilësisë është duke funksionuar në mënyrën e duhur. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet t'i ofrojë prodhuesit raportin e vizitës dhe, në qoftë se janë bërë testimet, me raportin e testimit.

7. Shënjjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

7.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE dhe shenjë plotësues të metrologjisë, të përcaktuar në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar të referuar në pikën 5.1, numrin e identifikimit këtij të fundit për secilin mjet matës individual që përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

7.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit e BE-së për çdo model të mjetit matës dhe ta mbaj atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse të një përdoruesi të vetëm.

8. Prodhuesi duhet, për periudhën pas 10 viteve pasi që mjeti matës është vendosur në treg, të mbajë ato në dispozicion për autoritetet kombëtare:

(a) dokumentacionin e referuar në pikën 5.1,

(b) informacionin në lidhje me ndryshimin të referuar në pikën 5.5;

(c) vendimet dhe raportet e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikat 5.5, 6.3 dhe 6.4.

9. Çdo trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informojë AMK-në për miratimet e lëshuara apo të anuluar të sistemit të cilësisë, dhe duhet të vë në dispozicion për AMK-në, periodikisht ose në bazë të kërkesës, listën e miratimeve të refuzuara, pezulluara ose kufizuara të sistemit të cilësisë.

10. Përfaqësuesi i autorizuar

11. Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3, 5.1, 5.5, 7 dhe 8 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë të specifikuara në mandat.

MODULI F: KONFORMITETI I TIPIT I BAZUAR NË VERIFIKIMIN E PRODUKTIT

1. Konformiteti i tipit të bazuar në verifikimin e produktit është pjesa e një procedure të vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi plotëson obligimet e përcaktuara në pikat 2, 5.1 dhe 6, dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi që mjetet matëse në fjalë, të cilat kanë qenë subjekt i dispozitave të pikes 3, janë në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipi-BE dhe përmbushin kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen tek këto mjete matëse.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij sigurojnë konformitetin e mjeteve matëse të prodhuara me tipin e miratuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipi-BE, dhe me kërkesat e kësaj Rregullore.

3. Verifikimi

Një trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit i zgjedhur nga prodhuesi duhet t'i kryejë shqyrtimet dhe testet e duhura në mënyrë që të kontrollojë konformitetin e mjeteve matëse me tipin e miratuar, të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipi-BE, dhe me kërkesat e përshtatshme të kësaj Rregullore.

- 3.1. Shqyrtimet dhe testet për të kontrolluar konformitetin e mjeteve matëse me kërkesat e përshtatshme duhet të kryhen, sipas zgjedhjes së prodhuesit, qoftë përmes ekzaminimit dhe testimit të çdo mjetit matës siç është specifikuar në pikën 4, apo përmes ekzaminimit dhe testimit të mjeteve matëse në bazë statistikore, siç është specifikuar në pikën 5.

4. Verifikimi i mjetit matës përmes shqyrtimit dhe testimit të çdo mjetit matës

- 4.1. Të gjitha mjetet matëse duhet të shqyrtohen individualisht dhe testet e duhura, të përcaktuara në standardin/standardet e harmonizuar relevante dhe / ose dokumentet normative, dhe / ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet tjera teknike relevante, duhet të kryhen në mënyrë që të verifikohet konformiteti i tyre me tipin e miratuar, të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të BE-së dhe me kërkesat e përshtatshme të kësaj Rregullore.

Në mungesë të një standardi të harmonizuar apo dokumenti normativ, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit në fjalë duhet të vendosë për testet e duhura që duhet të kryhen.

- 4.2. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të lëshojë certifikatën e konformitetit në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera, dhe duhet të vendosë numrin e saj të identifikimit në secilin mjet matës të miratuar, apo t'i vendos ato nën përgjegjësinë e saj.

Prodhuesi duhet të mbajë certifikatat e konformitetit në dispozicion për inspektim nga autoritetet kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

5. Verifikimi statistikor i konformitetit

5.1. Prodhuksi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë homogjenitetin e çdo grupi të prodhuar, dhe duhet të paraqesë mjetet e tij matëse për verifikim në formën e grupeve homogjene.

5.2. Një mostër e rastit duhet të merret nga çdo grup, në përputhje me kërkesat e pikës 5.3. Të gjitha mjetet matëse në një mostër duhet të ekzaminohen individualisht dhe testet e duhura, të përcaktuara në standardin/standardet e harmonizuar, dhe / ose dokumentin/dokumentet normative, dhe / ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet tjera teknike relevante, duhet të kryhen në mënyrë që të verifikohet konformiteti i tyre me tipin e përshkruar në certifikatën për ekzaminimin e tipit-BE dhe me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, dhe për të përcaktuar nëse grupi është pranuar ose refuzuar. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar apo dokumenti normativ, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit në fjalë duhet të vendosë për testet e duhura që duhet të kryhen.

5.3. Procedura statistikore duhet të plotësojë këto kërkesa:

Kontrolli statistikor do të bazohet në atributet. Sistemi i mostrimit duhet të sigurojë:

(a) Një nivel të kualitetit që korrespondon me probabilitetin e pranueshmërisë 95 %, me një jo-konformitet prej më pak se 1 %;

(b) Një limit të kualitetit që korrespondon me probabilitetin e pranueshmërisë 5 %, me një jo-konformitet prej më pak se 7 %;

5.4. Në qoftë se një grup pranohet, të gjitha mjetet matëse të grupit duhet të konsiderohen të miratuara, me përjashtim të atyre mjeteve matëse të mostrës që nuk përmbushin testet.

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit lëshon certifikatën e konformitetit në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera, dhe duhet të vendosë numrin e saj të identifikimit në secilin mjet matës të miratuar.

Prodhuksi duhet të mbajë certifikatat e konformitetit në dispozicion për autoritetet kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

5.5. Në qoftë se një grup është refuzuar, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të marrë masat e duhura për të parandaluar vendosjen e atij grupi në treg. Në rast të refuzimeve të shpeshta të grupeve, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të pezullojë verifikimin statistikor dhe të marrë masat e duhura.

6. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

6.1. Prodhuksi duhet të vendosë shenjë CE dhe shenjë plotësuese të metrologjisë, të përcaktuara në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar të referuar në pikën 3, numrin e identifikimit të këtij të fundit për secilin mjet matës individual që është në konformitet me llojin e miratuar të përshkruar në certifikatën për shqyrtimin e tipit-BE dhe përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

6.2. Prodhuksi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit e BE-së për çdo model të mjetit matës dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse të një

përdorues i vetëm.

Nëse trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit i referuar në pikën 3 pajtohet dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë gjithashtu tek mjetet matëse numrin e identifikimit të trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit.

7. Nëse trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit pajtohet dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë gjithashtu tek mjetet matëse numrin e identifikimit të trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit gjatë procesit të prodhimit.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë të specifikuara në mandat. Një përfaqësues i autorizuar mund të mos i përmbushë detyrimet e prodhuesit, të përcaktuara në pikat 2 dhe 5.1.

MODULI F1: KONFORMITETI I BAZUAR NË VERIFIKIMIN E PRODUKTIT

1. Konformiteti i bazuar në verifikimin e produktit është procedura e vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3, 6.1 dhe 7 dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi që mjetet matëse në fjalë, të cilat kanë qenë objekt i dispozitave të pikës 4, janë në konformitet me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen tek këto mjete matëse.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të përgatis dokumentacionin teknik ashtu si përshkruhet në nenin 18. Dokumentacioni duhet të mundësoj vlerësimin e konformitetit të mjetit matës me kërkesat përkatëse, dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm të rrezikut (rreziqeve). Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e aplikueshme dhe të mbulojë në mënyrën më të përshtatshme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e mjetit matës.

Prodhuesi duhet të mbajë dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve relevante kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

3. Prodhimi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e mjeteve matëse të prodhuara me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

4. Verifikimi

Një trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit i zgjedhur nga prodhuesi, duhet t'i kryej ekzaminimet dhe testet e duhura për të kontrolluar konformitetin e mjeteve matëse me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

Ekzaminimet dhe testet për të verifikuar konformitetin me kërkesat duhet të kryhen, sipas zgjedhjes së prodhuesit, qoftë përmes ekzaminimit dhe testimit të çdo mjeti matës, siç specifikohet në pikën 5, ose me ekzaminimin dhe testimin e mjeteve matëse në bazë statistikore, siç specifikohet në pikën 6.

5. Verifikimi i konformitetit përmes ekzaminimit dhe testimit të çdo mjeti matës

- 5.1. Të gjitha mjetet matëse duhet të ekzaminohen individualisht dhe testet e duhura, të përcaktuara në standardet përkatëse të harmonizuara, dhe / ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike relevante, duhet të kryhen për të verifikuar konformitetin me kërkesat që zbatohen tek ato. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, apo dokumenti normativ, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit në fjalë duhet të vendosë për testet e duhura që duhet të kryhen.

- 5.2. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të lëshojë një certifikatë të konformitetit në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera, dhe duhet të

vendosë numrin e saj të identifikimit tek secili mjet matës i miratuar, apo ti vendos ato nën përgjegjësinë e saj.

Prodhuesi duhet të mbajë certifikatat e konformitetit në dispozicion për autoritetet kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

6. Verifikimi statistikor i konformitetit

6.1. Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë homogjenitetin e çdo grupi të prodhuar, dhe duhet të paraqesë mjetet matëse të tij për verifikim në formën e grupeve homogjene.

6.2. Një mostër e rastit duhet të merret nga çdo grup, në përputhje me kërkesat e pikës 6.4.

6.3. Të gjitha mjetet matëse në një mostër duhet të ekzaminohen individualisht dhe testet e duhura, të përcaktuara në standardin/standardet e harmonizuar, dhe/ose dokumentin/dokumentet normative, dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet tjera teknike relevante, duhet të kryhen në mënyrë që të verifikohet konformiteti i tyre me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, dhe për të përcaktuar nëse grupi është pranuar ose refuzuar. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar apo dokumenti normativ, trupi i notifikuar në fjalë duhet të vendosë për testet e duhura që duhet të kryhen.

6.4. Procedura statistikore duhet të plotësojë këto kërkesa:

Kontrolli statistikor do të bazohet në atributet. Sistemi i mostrimit duhet të sigurojë:

(a) Një nivel të kualitetit që korrespondon me probabilitetin e pranueshmërisë 95 %, me një jo-konformitet prej më pak se 1 %;

(b) Një limit të kualitetit që korrespondon me probabilitetin e pranueshmërisë 5 %, me një jo-konformitet prej më pak se 7 %.

6.5. Në qoftë se një grup pranohet, të gjitha mjetet matëse të grupit duhet të konsiderohen të miratuara, me përjashtim të atyre mjeteve matëse të mostrës që nuk përmbushin testet. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit lëshon certifikatën e konformitetit në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera, dhe duhet të vendosë numrin e saj të identifikimit në secilin mjet matës të miratuar, apo ti vendos ato nën përgjegjësinë e vet.

Prodhuesi duhet të mbajë certifikatat e konformitetit në dispozicion për autoritetet kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

Në qoftë se një grup është refuzuar, trupi i notifikuar duhet të marrë masat e duhura për të parandaluar vendosjen e atij grupi në treg. Në rast të refuzimeve të shpeshta të grupeve, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të pezullojë verifikimin statistikor dhe të marrë masat e duhura.

7. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

7.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE dhe shenjë plotësues të metrologjisë, të përcaktuar në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikën 4, numrin e identifikimit këtij të fundit për secilin mjet matës individual që përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

7.2. Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit e BE-së për çdo model të mjetit matës dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës është vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve përkatëse sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së do të jepet së bashku me çdo mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të

interpretohet si aplikim për një seri apo ngarkesë në vend se mjete matëse të veçanta, në ato raste kur dorëzohet një numër i madh i mjeteve matëse të një përdoruesi të vetëm.

Nëse trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit i referuar në pikën 5 pajtohet dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë gjithashtu tek mjetet matëse numrin e identifikimit të trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit.

8. Nëse trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit pajtohet dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë gjithashtu tek mjetet matëse numrin e identifikimit të trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit gjatë procesit të prodhimit.

9. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë të specifikuara në mandat. Një përfaqësues i autorizuar mund të mos i përmbushë detyrimet e prodhuesit, të përcaktuara në pikën 2, paragrafi i parë, pikën 3 dhe pikën 6.1.

MODULI G: KONFORMITETI I BAZUAR NË VERIFIKIMIN E NJËSISË

1. Konformiteti i bazuar në verifikimin e njësisë është procedura e vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 5 dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi që mjetet matëse në fjalë, të cilat kanë qenë objekt i dispozitave të pikës 4, janë në konformitet me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen tek këto mjete matëse.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të krijojë dokumentacionin teknik siç përshkruhet në Nenin 18 dhe ta vë në dispozicion të trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit, të referuar në pikën 4. Dokumentacioni duhet ta mundësojë vlerësimin e konformitetit të mjetit matës me kërkesat relevante, dhe duhet të përfshijë një analizë të duhur dhe vlerësim të rrezikut/reziqueve. Dokumentacioni teknik duhet të specifikojë kërkesat e zbatueshme dhe të mbulojë, aq sa është e rëndësishme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e mjetit matës.

Prodhuesi duhet të mbajë dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare relevante për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

3. Prodhimi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e mjetit matës të prodhuar me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

4. Verifikimi

Një i trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit i zgjedhur nga prodhuesi duhet të kryej ekzaminimet dhe testet e duhura, të përcaktuara në standardet e harmonizuara relevante, dhe / ose dokumentet normative, ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike relevante, në mënyrë që të verifikohet konformiteti i mjetit matës me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, ose të kryhen nga dikush tjetër. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, ose dokumenti normativ, trup i notifikuar në fjalë do të vendosë për testet e duhura që duhet të kryhen.

Trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të lëshojë certifikatën e konformitetit në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe të vendosë numrin e saj të identifikimit tek mjeti matës i miratuar, apo të vendosë nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi duhet t'i mbajë certifikatat e konformitetit në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

5. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

5.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjën CE dhe shënjin plotësues të metrologjisë, të përcaktuara në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikën 4, numrin e identifikimit të këtij të fundit për secilin mjet matës që përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

5.2. Prodhuesi duhet të hartojë deklaratën e konformitetit e BE-së dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet, pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë mjetin matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të vihet në dispozicion të autoriteteve relevante sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të jepet me mjetin matës.

6. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit, të përcaktuara në pikat 2 dhe 5, mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë të specifikuara në mandat.

MODULI H: KONFORMITETI I BAZUAR NË SIGURIMIN E PLOTË TË CILËSISË

1. Konformiteti i bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë është procedura e vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5 dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi që mjetet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen tek këto mjete matëse.

2. Prodhimi

Prodhuesi duhet të operojë një sistem të miratuar të cilësisë për projektimin, prodhimin dhe inspektimin e produktit final dhe testimin e mjeteve matëse në fjalë, siç specifikohet në pikën 3, dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes, siç specifikohet në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi, përmes një trupi të autorizuar për vlerësim të konformitetit, të zgjedhur nga ai, duhet të paraqes një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për mjetet matëse në fjalë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

(a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar.

(b) dokumentacionin teknik, siç është përshkruar në nenin 18, nga një model të secilës kategori të mjeteve matëse të destinuara për tu prodhuar. Dokumentacioni duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të mjetit matës me kërkesat relevante, dhe duhet të përfshijë një analizë dhe vlerësim të duhur të rrezikut/rreziqeve. Dokumentacioni teknik duhet të specifikojë kërkesat e zbatueshme dhe të mbuloj, aq sa është e rëndësishme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e mjetit matës.

(c) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë, dhe

(d) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë tjetër trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit.

3.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhjen e mjeteve matëse me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për këto mjete matëse.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e pranura nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve. Ky dokumentim i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave lidhur me cilësinë.

Duhet të përmbajë, në veçanti, një përshkrim të duhur të:

- (a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhmentit në lidhje me cilësinë e produktit;
- (b) specifikimet teknike të projektimit, duke përfshirë standardet që do të zbatohen dhe aty ku standardet e harmonizuara relevante, dhe / ose dokumente normative nuk do të zbatohen plotësisht, mjetet që do të përdoren për të siguruar që kërkesat thelbësore të kësaj Rregullore që zbatohen për mjetet matëse do të plotësohen duke zbatuar specifikimet e tjera teknike relevante;
- (c) teknikave të kontrollit dhe të verifikimit të projektimit, proceseve dhe veprimeve sistematike që do të përdoren gjatë projektimit të mjeteve matëse, që i përkasin kategorisë së mbuluar të mjetit matës;
- (d) prodhimit përkatës, teknikave të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike të cilat do të përdoren;
- (e) ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, dhe shpeshtësisë me të cilën mendohet të kryhen;
- (f) të dhënave lidhur me cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë;
- (g) mjeteve të monitorimit të arritjes së projektimit dhe cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2.

Duhet të supozojë konformitetin me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që janë në përputhje me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar relevant.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë si vlerësues në fushën e mjetit matës dhe teknologjisë së mjetit matës në fjalë, dhe me njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

Auditimi duhet të përfshijë një vizitë vlerësimi në objektet e prodhuesit.

Ekipi i auditimit duhet të ekzaminojë dokumentacionin teknik të referuar në pikën (b) të pikës 3.1, në mënyrë që të verifikojë aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat relevante të kësaj Rregullore dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë së mjetit matës me këto kërkesa.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të njoftohen mbi vendimin. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e auditimit dhe vendimin arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta ruajë atë, në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.

3.5. Prodhuesi duhet ta mbajë trupin e notifikuar, që e ka miratuar sistemin e cilësisë, të informuar për çdo ndryshim të planifikuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë çdo ndryshim të propozuar dhe të vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë do të vazhdojë të përmbush kërkesat e referuara në pikën 3.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit

4.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është për t'u siguruar që prodhuesi përmbush siç duhet detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2. Për qëllime të vlerësimit, prodhuesi duhet t'i lejojë trupit të notifikuar qasje në prodhim, inspektim, testim dhe vendet e magazinimit dhe t'i ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

(a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

(b) të dhënat e cilësisë, siç parashikohet nga pjesa e projektimit të sistemit të cilësisë, të tilla si rezultatet e analizave, llogaritjeve, testeve;

(c) të dhënat e cilësisë, siç është paraparë për pjesën prodhuese të sistemit të cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë.

4.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të kryejë auditime periodike për të siguruar që prodhuesi ruan dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i jep prodhuesit një raport të auditimit.

4.4. Përveç kësaj, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të bëjë vizita të pa paralajmëruara tek prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, nëse është e nevojshme, mund të bëjë teste të mjetit matës për të verifikuar që sistemi i cilësisë është duke funksionuar në mënyrën e duhur. Duhet ta furnizoj prodhuesin me një raport të vizitës dhe, në qoftë se janë bërë testimet, me një raport të testimi.

5. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

5.1. Prodhuesi duhet të vendosë shenjën CE dhe shënjin plotësues të metrologjisë, të përcaktuara në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikën 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit për secilin mjet matës që përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

5.2. Prodhuesi duhet të hartojë deklaratën e konformitetit e BE-së dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet, pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë mjetin matës për të cilin është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të vihet në dispozicion të autoriteteve relevante sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të jepet me secilin mjet matës që është vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si e zbatueshme për një grup apo ngarkesë, në vend se për mjete matëse individuale, në ato raste kur një numër i madh i mjeteve matëse është dorëzuar tek një përdorues i vetëm.

6. Prodhuesi duhet, për një periudhë prej 10 vitesh pasi që mjeti matës është vendosur në treg, t'i mbajë në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

(a) dokumentacionin teknik të referuar në pikën 3.1,

- (b) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë të referuar në pikën 3.1,
 - (c) informacionin në lidhje me ndryshimin të referuar në pikën 3.5;
 - (d) vendimet dhe raportet e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.
7. Çdo trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informojë personin e saj të autorizuar për miratimet e lëshuara apo të anuluar të sistemit të cilësisë, dhe duhet të vë në dispozicion të autoritetit të tij të autorizuar, periodikisht ose në bazë të kërkesës, listën e miratimeve të refuzuara, pezulluara ose kufizuara të sistemit të cilësisë.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit, të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6, mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë të specifikuara në mandat.

MODULI H1: KONFORMITETI I BAZUAR NË SIGURIMIN E PLOTË TË CILËSISË PLUS EKZAMINIMIN E PROJEKTIMIT

1. Konformiteti i bazuar në sigurimin e plotë të cilësisë plus ekzaminimi i projektimit është procedura e vlerësimit të konformitetit përmes së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 6 si dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësi që mjetet matëse në fjalë përmbushin kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen tek këto mjete matëse.
2. **Prodhimi**
Prodhuesi duhet të operojë një sistem të miratuar të cilësisë për projektimin, prodhimin dhe inspektimin e produktit final dhe testimin e mjeteve matëse në fjalë, siç specifikohet në pikën 3, dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes, siç specifikohet në pikën 5.

Përshtatshmëria e projektimit teknik të mjeteve matëse duhet të jetë ekzaminuar në përputhje me pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

- 3.1. Prodhuesi, përmes një trupi të autorizuar për vlerësim të konformitetit të zgjedhur nga ai, duhet të paraqes një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për mjetet matëse në fjalë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

- (a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar;
- (b) të gjitha informacionet relevante për kategorinë e paraparë të mjetit matës;
- (c) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;
- (d) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë tjetër trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit.

3.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhjen e mjeteve matëse me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për këto mjete matëse.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e pranura nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e polikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentim i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave lidhur me cilësinë.

Duhet të përmbajë, në veçanti, një përshkrim të duhur të:

- (a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësi dhe kompetencave të menaxhmentit në lidhje me cilësinë e produktit;
- (b) specifikimet teknike të projektimit, duke përfshirë standardet që do të zbatohen dhe aty ku standardet e harmonizuara relevante, dhe / ose dokumente normative nuk do të zbatohen plotësisht, mjetet që do të përdoren për të siguruar që kërkesat thelbësore të kësaj Rregullore që zbatohen për mjete matëse do të plotësohen duke aplikuar specifikimet e tjera teknike relevante;
- (c) teknikave të kontrollit dhe të verifikimit të projektimit, proceseve dhe veprimeve sistematike që do të përdoren gjatë projektimit të mjeteve matëse, që i përkasin kategorisë së mbuluar të mjetit matës;
- (d) prodhimit përkatës, teknikave të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike të cilat do të përdoren;
- (e) ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, dhe shpeshësisë me të cilën mendohet të kryhen;
- (f) të dhënat lidhur me cilësinë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë;
- (g) mjeteve të monitorimit të arritjes së projektimit dhe cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

3.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2. Duhet të supozojë konformitetin me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që janë në përputhje me specifikimet përkatëse të standardit të harmonizuar relevant.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë si vlerësues në fushën mjetit matës dhe teknologjisë së mjetit matës relevant, dhe me njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore. Auditimi do të përfshijë një vizitë vlerësuese në objektet e prodhuesit.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të njoftohen për vendimin. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4. Prodhuesi duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta ruajë atë, në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.

3.5. Prodhuesi duhet ta mbajë trupin e autorizuar për vlerësim të konformitetit, që e ka miratuar sistemin e cilësisë, të informuar për çdo ndryshim të planifikuar në sistemin e cilësisë.

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e referuara në pikën 3.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Duhet të njoftoj prodhuesin ose përfaqësuesin e tij të autorizuar për vendimin. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.6. Çdo trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informojë AMK-në për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo të anuluar, dhe duhet të vë në dispozicion të AMK-së, periodikisht apo sipas kërkesës, listën e miratimeve të sistemit të cilësisë të refuzuara, pezulluara ose kufizuara.

4. Ekzaminimi i projektimit

4.1. Prodhuesi duhet të paraqes një kërkesë për ekzaminimin e projektimit përmes një trupi të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikën 3.1.

4.2. Përmes kërkesës duhet të mundësohet kuptimi i projektimit, prodhimit dhe funksionimit të mjetit matës, dhe vlerësimi i konformitetit me kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen në të.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- (a) Emrin dhe adresën e prodhuesit;
 - (b) një deklaratë me shkrim që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur tek ndonjë tjetër trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit;
 - (c) dokumentacionin teknik, siç është përshkruar në nenin 18. Përmes dokumentacionit duhet të mundësohet vlerësimi i konformitetit të mjetit matës me kërkesat relevante, dhe një analizë dhe vlerësim i duhur i rrezikut/rreziqeve duhet të përfshihet në dokumentacion. Gjithashtu duhet të mbuloj projektimin dhe funksionimin e mjetit matës, aq sa është e rëndësishme për një vlerësim të tillë;
 - (d) dëshmi mbështetëse për përshtatshmërinë e projektimit teknik. Kjo dëshmi mbështetëse duhet të përmend të gjitha dokumentet që janë përdorur, në mënyrë të veçantë aty ku standardet e harmonizuara relevante dhe / ose dokumentet normative nuk janë zbatuar plotësisht, dhe duhet të përfshijnë, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera në përputhje me specifikimet e tjera teknike relevante nga laborator i adekuat i prodhuesit, ose nga një tjetër laborator testimi në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.
- 4.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të shqyrtojë kërkesën, dhe aty ku projektimi i plotëson kërkesat e kësaj Rregullore që zbatohen për mjetin matës, duhet të lëshojë për prodhuesin një certifikatë të ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së. Kjo certifikatë duhet të përmbajë emrin dhe adresën e prodhuesit, konkluzionet e ekzaminimit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e tij dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e projektimit të miratuar. Kjo certifikatë mund të ketë të bashkëngjitur një ose më shumë shtojca.

Kjo certifikatë dhe shtojcat e saj duhet të përmbajnë të gjitha informatat relevante për të lejuar vlerësimin e konformitetit të mjeteve matëse të prodhuara me projektimin e ekzaminuar dhe për të lejuar kontrollin në punë (in service). Duhet të lejojë vlerësimin e konformitetit të mjeteve matëse të prodhuara me projektimin e ekzaminuar në lidhje me riprodhueshmërinë e performancave të tyre metrologjike, kur ato janë përshtatur siç duhet, duke përdorur mjetet e duhura, përfshirë këtu:

- (a) Karakteristikat metrologjike të projektimit të mjetit matës;
- (b) Masat e kërkuara për sigurimin e integritetit të mjeteve matëse (mbylljen, izolimin, identifikimi i softuerit, etj.);
- (c) informacionet për elementet e tjera, të nevojshme për identifikimin e mjetit matës dhe për të kontrolluar konformitetin e tij të jashtëm vizual me projektimin;
- (d) nëse është e nevojshme, çdo informacion specifik të nevojshëm për verifikimin e karakteristikave të mjeteve matëse të prodhuara;
- (e) në rast të nën-sistemit, të gjitha informacionet e duhura për të siguruar përshtatshmërinë me nën-sistemet tjera apo mjetet matëse.

Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të krijojë një raport vlerësimi në këtë drejtim dhe ta mbajë atë në dispozicion të AMK-së. Pa rënë ndesh me Nenin 27, paragrafi 10, trupi i notifikuar duhet të nxjerrë përmbajtjen e këtij raporti, në tërësi ose pjesërisht, vetëm me pëlqimin e prodhuesit.

Certifikata duhet të jetë valide për 10 vjet nga data e lëshimit të saj, dhe mund të rinovohet për periudha pasuese 10 vjeçare.

Kur projektimi nuk i përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të refuzojë lëshimin e një certificate të ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së dhe duhet të informojë aplikuesin, duke i dhënë arsyet e hollësishme për refuzimin e saj.

- 4.4. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informohet për çdo ndryshim në gjendjen më të mirë përgjithësisht të pranuar e cila tregon se projektimi i miratuar mund të mos përputhet më me kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore, dhe duhet të përcaktojë nëse ndryshimet e tilla kërkojnë hetime të mëtejshme. Nëse është kështu, trupi i autorizuar duhet ta informojë prodhuesin në përputhje me rrethanat. Prodhuesi duhet të mbajë të informuar trupin e notifikuar, që ka lëshuar certifikatën e ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së për çdo modifikim të projektimit të miratuar që mund të ndikojë konformitetin me kërkesat thelbësore të kësaj Rregullore ose kushtet për vlefshmërinë e certifikatës. Modifikimet e tilla duhet të kërkojnë aprovim shtesë - nga trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit që e ka lëshuar certifikatën e ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së në formën e një shtese të certifikatës origjinale të ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së.
- 4.5. Çdo trup i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të informojë AMK-në për certifikatën e ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së dhe / ose ndonjë shtesë të saj që e ka lëshuar apo anuluar, dhe duhet të vë në dispozicion të autoritetit të tij notifikues, periodikisht ose në bazë të kërkesës, listën e certifikatave dhe / ose ndonjë shtesë të refuzuar, pezulluar ose kufizuar. Komisioni Evropian dhe trupat e tjerë të autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të marrin, sipas kërkesës, një kopje të certifikatave të ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së dhe / ose shtesa. Sipas kërkesës, Komisioni Evropian mund të marr një kopje të dokumentacionit teknik dhe të rezultateve të ekzaminimeve të kryera nga trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të mbajë, deri në skadimin e vlefshmërisë së certifikatës, një kopje të certifikatës së ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së, shtojcat dhe shtesat e saj si dhe dosjen teknike, duke përfshirë edhe dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi.
- 4.6. Prodhuesi duhet të mbajë një kopje të certifikatës së ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së, shtojcat dhe shtesat e saj me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg.

5. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e trupit të notifikuar

- 5.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është për t'u siguruar që prodhuesi përmbush në mënyrën e duhur detyrimet që dalin nga sistemi i miratuar i cilësisë.
- 5.2. Për qëllime të vlerësimit, prodhuesi duhet t'i lejojë trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit qasje në projektim, prodhim, inspektim, testim dhe vendet e magazinimit, dhe t'i ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:
- (a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
 - (b) të dhënat e cilësisë, siç parashikohet nga pjesa e projektimit të sistemit të cilësisë, të tilla si rezultatet e analizave, llogaritjeve, testeve, etj.;
 - (c) të dhënat e cilësisë, siç parashikohet nga pjesa e prodhimit të sistemit të cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë, etj.
- 5.3. Trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit duhet të kryejë auditime periodike për të siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i jap prodhuesit një raport të auditimit.
- 5.4. Përveç kësaj, trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit mund të bëjë vizita të pa paralajmëruara tek prodhuesi. Gjatë vizitave të tilla trupi i autorizuar për vlerësim të konformitetit, nëse është e nevojshme, mund të bëjë teste të produktit për të verifikuar që sistemi i cilësisë është duke funksionuar në mënyrën e

duhur. Duhet ta furnizoj prodhuesin me një raport të vizitës dhe, në qoftë se janë bërë testimet, me një raport të testimit.

6. Shënjimi i konformitetit dhe deklarata e konformitetit e BE-së

6.1. Prodhuksi duhet të vendosë shenjën CE dhe shënjimin plotësues të metrologjisë, të përcaktuara në këtë Rregullore, dhe, nën përgjegjësinë e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikën 3.1, numrin e identifikimit të këtij të fundit për secilin mjet matës që përmbush kërkesat e zbatueshme të kësaj Rregullore.

6.2. Prodhuksi duhet të hartojë deklaratën e konformitetit e BE-së për çdo model të mjetit matës dhe ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet, pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg. Deklarata e konformitetit e BE-së duhet të identifikojë modelin e mjetit matës për të cilin është përpiluar, dhe duhet të cekë numrin e certifikatës së ekzaminimit sipas dizajnit të BE-së.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të vihet në dispozicion të autoriteteve relevante sipas kërkesës.

Një kopje e deklaratës së konformitetit e BE-së duhet të jepet me çdo mjet matës të vendosur në treg. Megjithatë, kjo kërkesë mund të interpretohet si e zbatueshme për një grup apo ngarkesë, në vend se për mjete matëse individuale, në ato raste kur një numër i madh i mjeteve matëse është dorëzuar tek një përdorues i vetëm.

7. Prodhuksi duhet, që për një periudhë që përfundon 10 vjet pasi që mjeti matës të jetë vendosur në treg, t'i mbajë në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

(a) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë të referuar në pikën 3.1,

(b) informacioni që lidhet me ndryshimet e referuara në pikës 3.5, ashtu siç është miratuar ;

(c) vendimet dhe raportet e trupit të autorizuar për vlerësim të konformitetit të referuar në pikat 3.5, 5.3 dhe 5.4.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqesë kërkesën të referuar në pikat 4.1 dhe 4.2, dhe të përmbush obligimet e përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 4.4, 4.6, 6 dhe 7, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, në qoftë se ato janë specifikuar në mandat.

A SHTOJCA III

UJËMATËSIT (MI-001)

Kërkesat relevante të Shtojcës I, kërkesat specifike të kësaj Shtojce dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të listuara në këtë Shtojcë, zbatohen në ujëmatësit e destinuar për matjen e vëllimeve të ujit të pastër, të ftohtë apo të nxehtë në shfrytëzim nga amvisëritë, shfrytëzim komercial dhe në shfrytëzim nga industritë e lehta.

PËRKUFIZIMET

Ujëmatës	Një mjet matës i dizajnuar për të matur, memorizuar dhe shfaqur vëllimin në kushte të matjes së ujit që kalon nëpërmjet shndërruesit të matjes.	
Prurja minimale e rrjedhës (Q ₁)	Prurja më e ulët në të cilën ujëmatësit jep indikacione që përbushin kërkesat në lidhje me gabimet maksimale të lejueshme (MPE).	
Prurja kalimtare e rrjedhës (Q ₂)	Prurja kalimtare e rrjedhës është vlera e prurjes që ndodh në mes të prurjes së përhershme dhe prurjes minimale, në të cilin rangi i prurjes është i ndarë në dy zona, në 'zonën e epërme' dhe 'zonën e poshtme'. Çdo zonë ka një MPE karakteristike.	
Prurja e përhershme e rrjedhës (Q ₃)	Prurja më e madhe e rrjedhës në të cilën ujëmatësi vepron në mënyrë të kënaqshme në kushte normale të shfrytëzimit, dmth në kushte të qëndrueshme ose me ndërprerje të rrjedhës.	
Prurja e mbingarkuar e rrjedhës (Q ₄)	Prurja e mbingarkuar e rrjedhës është prurja më e madhe e rrjedhës në të cilën matësi operon në mënyrë të kënaqshme për një periudhë të shkurtër kohore, pa u përkeqësuar.	

KËRKESAT SPECIFIKE

Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Prodhuesi duhet të specifikojë kushtet e vlerësuara të funksionimit për mjetin matës, në veçanti:

1. Rangu i prurjes së ujit.

Vlerat për rangun e prurjes së rrjedhës duhet të përbushin kushtet e mëposhtme:

$$Q_3/Q_1 \geq 40$$

$$Q_2/Q_1 = 1,6$$

$$Q_4/Q_3 = 1,25$$

2. Rangu i temperaturës së ujit.

Vlerat për rangun e temperaturës duhet të përbushin kushtet e mëposhtme:

0,1 °C deri në së paku 30 °C, ose

30 °C deri në së paku 90 °C.

Mjeti matës mund të dizajnohet që të operoj në të dy rangjet.

3. Rangu i presionit relativ të ujit, rang nga 0,3 bar deri në së paku 10 bar në Q_3 .
4. Për furnizimin me energji: vlera nominale e furnizimit me tensionin AC dhe/ose kufijtë e furnizimit DC.

GML

5. GML, qoftë pozitive apo negative, në vëllimet e paraqitura në prurjet e rrjedhës në mes prurjes së kalimtare të rrjedhës (Q_2) (e përfshirë) dhe prurjes së mbingarkuar të rrjedhës (Q_4) është:

2 % për ujin në temperaturë ≤ 30 °C,

3 % për ujin në temperaturë > 30 °C.

Matësi nuk duhet të shfrytëzojë GML-në ose të favorizoj në mënyrë sistematike ndonjë palë.

6. GML-ja pozitive ose negative, në vëllimet e ofruara në prurjet e rrjedhës në mes prurjes minimale të rrjedhës (Q_1) dhe prurjes së kalimtare të rrjedhës (Q_2) (e përjashtuar) është 5 % për ujin në çfarëdo temperature.

Matësi nuk duhet të shfrytëzojë GML-në ose të favorizoj në mënyrë sistematike ndonjë palë.

Ndikimi i lejueshëm i çrregullimeve

7.1. Imuniteti elektromagnetik

7.1.1. Ndikimi i një çrregullimi elektromagnetik në një ujëmatës duhet të jetë i tillë që:

- Ndryshimi në rezultatin e matjes nuk është më i madh sesa vlera kritike e ndryshimit siç është përcaktuar në pikën 7.1.3, ose
- Paraqitja e rezultatit të matjes është e tillë që nuk mund të interpretohet si rezultat valid, sikur se një luhatje e momentit që nuk mund të interpretohet, memorizohet apo transmetohet si një rezultat i matjes.

7.1.2. Pas pësimit të një çrregullimi elektromagnetik, ujëmatësi duhet:

- të rregullohet për të funksionuar brenda GML-së, dhe
- të ketë të gjitha funksionet e matjes të mbrojtura, dhe
- lejoj rimëkëmbjen e të gjitha të dhënave të matjes që kanë qenë para paraqitjes së çrregullimit.

7.1.3. Vlera kritike e ndryshimit është më e vogla nga dy vlerat vijuese:

- vëllimi që korrespondon me gjysmën e magnitudës së GML-së në zonën e epërme të vëllimit të matur;
- vëllimi që korrespondon me GML-në e vëllimit që korrespondon për një minutë në prurjen e rrjedhës Q_3 .

7.2. Qëndrueshmëria

Pasi që është kryer një test i duhur, duke marrë parasysh periudhën kohore të vlerësuar nga prodhuesi, duhet të përmbushen kriteret e mëposhtme:

7.2.1. Ndryshimi i rezultatit të matjes pas testit të qëndrueshmërisë, kur krahasohet me rezultatin e matjes fillestare, nuk duhet të kalojë:

- 3% të vëllimit të matur mes Q_1 të përfshirë dhe Q_2 të përjashtuar;
- 1,5 % të vëllimit të matur mes Q_2 të përfshirë dhe Q_4 të përjashtuar.

7.2.2. Gabimi i treguesit për vëllimin e matur pas testit të qëndrueshmërisë nuk duhet të tejkalojë:

- $\pm 6\%$ të vëllimit të matur mes Q_1 të përfshirë dhe Q_2 të përjashtuar;
- $\pm 2,5\%$ të vëllimit të matur midis Q_2 të përfshirë dhe Q_4 të përfshirë për matësit e ujit, që janë të destinuar për matjen e ujit në temperaturë midis $0,1\text{ }^{\circ}\text{C}$ dhe $30\text{ }^{\circ}\text{C}$,
- $\pm 3,5\%$ të vëllimit të matur midis Q_2 të përfshirë dhe Q_4 të përfshirë për matësit e ujit, që janë të destinuar për matjen e ujit në temperaturë midis $30\text{ }^{\circ}\text{C}$ dhe $90\text{ }^{\circ}\text{C}$.

Përshtatshmëria

8.1. Matësi duhet të jetë në atë gjendje që të mund të instalohet për të operuar në çdo pozicion, përveç nëse nuk shënohet ndryshe.

8.2. Prodhuesi duhet të specifikojë nëse matësi është krijuar për të matur rrjedhën kthyese. Në një rast të tillë, vëllimi i rrjedhës së kundërt duhet ose do të zbritet nga vëllimi i grumbulluar ose duhet të regjistrohet veçmas. E njëjta GML duhet të zbatohet për të dy rrjedhat, rrjedhën hyrëse dhe rrjedhjen kthyese.

Matësit e ujit, të cilët nuk janë të dizajnuar për të matur rrjedhën kthyese, ose do të pengojnë rrjedhën e kthyese ose do t'i rezistojnë rrjedhës aksidentale kthyese, pa ndonjë përkeqësim apo ndryshim në karakteristikat metrologjike.

Njësitë e matjes

9. Vëllimi i matur do të paraqitet në metra kub.

Vënia në shfrytëzim

10. Distributori apo personi i caktuar ligjërisht për instalimin e ujëmatësit siguron kërkesat sipas pikave 1, 2 dhe 3, në mënyrë që ujëmatësi të jetë i përshtatshëm për matjen e saktë të konsumit që është parashikuar ose të planifikuar.

VLERËSIMI I KONFORMITETIT

Procedurat e vlerësimit të konformitetit të referuara në Nenin 17, mes të cilave prodhuesi mund të zgjedhë, janë: B + F ose B + D ose H1.

SHTOJCA IV

MATËSIT E GAZIT DHE PAJISJET PËR KONVERTIMIN E VËLLIMIT (MI-002)

Kërkesat relevante të Shtojcës I, kërkesat specifike të kësaj Shtojce dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të listuara në këtë Shtojcë, zbatohen për matësit e gazit dhe pajisjet e konvertimit të vëllimit të përcaktuara më poshtë, të destinuara për shfrytëzim nga amvisëritë, shfrytëzim komercial dhe për shfrytëzim nga industritë e lehta.

PËRKUFIZIMET

Matësit e gazit	Një mjet matës i krijuar për të matur, memorizuar dhe shfaqur sasinë e gazit të karburantit (vëllim ose masën) që ka kaluar nëpër atë mjet matës.
Pajisja e konvertimit	Një pajisje e vendosur tek një matës i gazit që konverton automatikisht sasinë e matur në kushte të matjes në një sasi në kushte bazë.
Prurja minimale e rrjedhës (Q_{min})	Prurja më e ulët e rrjedhës në të cilën matësi i gazit jep indikacione që përmbushin kërkesat në lidhje me gabimin maksimal të lejuar (GML).
Prurja maksimale e rrjedhës (Q_{max})	Prurja më e madhe e rrjedhës në të cilën matësi i gazit jep indikacione që përmbushin kërkesat në lidhje me GML.
Prurja kalimtare e rrjedhës (Q_t)	Prurja kalimtare e rrjedhës është vlera e prurjes që ndodh në mes të prurjes së përhershme dhe prurjes minimale, në të cilin rangi i prurjes është i ndarë në dy zona, në 'zonën e epërme' dhe 'zonën e poshtme'. Çdo zonë ka një GML karakteristike.
Prurja e mbingarkuar e rrjedhës (Q_r)	Prurja e mbingarkuar e rrjedhës është prurja më e madhe e rrjedhës në të cilën matësi operon në mënyrë të kënaqshme për një periudhë të shkurtër kohore, pa u përkeqësuar.
Kushtet bazë	Kushtet specifike për të cilat sasia e matur e lëngut është shndërruar.

PJESA I

KËRKESAT SPECIFIKE MATËSIT E GAZIT

1. Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Prodhuesi duhet të specifikojë kushtet e vlerësuara të funksionimit të matësit të gazit, duke marrë parasysh:

1.1. Rangun i prurjes së gazit duhet t'i përmbush së paku kushtet e mëposhtme:

Klasa	Q_{max}/Q_{min}	Q_{max}/Q_t	Q_t/Q_{max}
1,5	≥ 150	≥ 10	1,2

1,0	≥ 20	≥ 5	1,2
-----	-----------	----------	-----

1.2. Rangu temperaturor i gazit, me një rang minimal prej 40 °C.

1.3. *Kushtet e ndërlihdura me karburantin / gazin*

Matësi i gazit duhet të dizajnohet për rangun e gazeve dhe presionet e furnizimit të vendit të destinacionit. Në mënyrë të veçantë, prodhuesi duhet të paraqes:

- Familjen apo grupin e gazit;
- presionin maksimal.

1.4. Një rang temperaturor minimal prej 50 °C për mjedisin klimatik.

1.5. Vlera nominale e furnizimit të tensionit AC dhe/ose kufijtë e furnizimit DC.

2. **Gabimet maksimale të lejueshme (GML)**

2.1. Matësi i gazit paraqet vëllimin në kushtet e matjes apo masën

Tabela 1

Klasa	1,5	1,0
$Q_{\min} \leq Q < Q_t$	3 %	2 %
$Q_t \leq Q \leq Q_{\max}$	1,5 %	1 %

Matësi nuk duhet të shfrytëzojë GML-në ose të favorizoj në mënyrë sistematike ndonjë palë.

2.2. Për një matës të gazit me shndërrim të temperaturës, i cili vetëm tregon vëllimin e shndërruar, GML- e matësit është rritur me 0,5% në një rang prej 30 ° C, e shtrirë në mënyrë simetrike rreth temperaturës së përcaktuar nga prodhuesi që shtrihet midis 15 ° C dhe 25 ° C. Jashtë këtij rangi, një rritje shtesë prej 0,5% është e lejuar në çdo interval prej 10 ° C.

3. **Ndikimi i lejueshëm i çrregullimeve**

3.1. *Imuniteti elektromagnetik*

3.1.1. Ndikimi i një çrregullimi elektromagnetik në një matës të gazit ose pajisje për shndërrimin e vëllimit duhet të jetë i tillë që:

- Ndryshimi në rezultatin e matjes nuk është më i madh sesa vlera kritike e ndryshimit siç përcaktohet në pikën 3.1.3, ose
- paraqitja rezultativit të matjes është e tillë që nuk mund të interpretohet si rezultat valid, sikur se një luhatje e momentit që nuk mund të interpretohet, memorizohet apo transmetohet si një rezultat i matjes.

3.1.2. Pas pësimit të një çrregullimi elektromagnetik, matësi i gazit duhet:

- të rimëkëmbet për të funksionuar brenda GML, dhe
- të ketë të gjitha funksionet e matjes të ruajtura, dhe
- të lejoj rimëkëmbjen e të gjitha të dhënave të matjes që kanë qenë para paraqitjes së çrregullimit.

3.1.3. Vlera kritike e ndryshimit është më e vogla nga dy vlerat vijuese:

- sasia që korespondon me gjysmën e magnitudës së GML-së në zonën e epërme të vëllimit të matur;
- sasia që korespondon me GML-së me sasinë që korrespondon me një minutë në prurjen maksimale të rrjedhës.

3.2. *Ndikimi i çrregullimeve të rrjedhës në rrjedhën e epërme –rrjedhën e poshtme*

Sipas kushteve të instalimit të specifikuara nga prodhuesi, ndikimi i çrregullimeve të rrjedhës nuk duhet të kalojë një të tretën e GML-së

4. **Qëndrueshmëria**

Pasi që është kryer një test i duhur, duke marrë parasysh periudhën kohore të vlerësuar nga prodhuesi, duhet të përmbushen kriteret e mëposhtme:

4.1. *Klasa 1,5 \$3*

4.1.1. Ndryshimi i rezultatit të matjes pas testit të qëndrueshmërisë, kur krahasohet me rezultatin e matjes fillestare për prurjet e rrjedhës në rangun Q_t deri te Q_{max} - nuk duhet ta tejkalojë rezultatin e matjes për më shumë se 2 %.

4.1.2. Ndryshimi i rezultatit të matjes pas testit të qëndrueshmërisë nuk duhet të tejkalojë dy herë GML-në në pikën 2.

4.2. *Klasa 1,0 \$3*

4.2.1. Ndryshimi i rezultatit të matjes pas testit të qëndrueshmërisë, kur krahasohet me rezultatin fillestar të matjes, nuk duhet të tejkalojë një të tretën e GML-së në pikën 2.

4.2.2. Gabimi i treguesit për vëllimin e matur pas testit të qëndrueshmërisë nuk duhet të tejkalojë GML-në në pikën 2.

5. **Përshtatshmëria**

5.1. Një matës i gazit i furnizuar nga rrjeti elektrik (AC ose DC) duhet të pajiset me një pajisje emergjente të furnizimit me energji ose mjete të tjera në mënyrë që të sigurojë se, gjatë një dështimi të burimit kryesor të energjisë, të gjitha funksionet matëse janë të mbrojtura.

5.2. Një burim i dedikuar për energji elektrike duhet të ketë një jetëgjatësi për të paktën pesë vite. Pas kalimit të 90% të jetëgjatësisë së tij, duhet të shfaqet një paralajmërim i duhur.

- 5.3. Një pajisje treguese duhet të ketë një numër të mjaftueshëm të shifrave për të siguruar që sasia e kaluar gjatë 8 000 orëve në Qmax nuk i kthen shifrat në vlerat e tyre fillestare.
- 5.4. Matësi i gazit duhet të jetë në atë gjendje që të mund të instalohet për të operuar në çdo pozicion të deklaruar nga prodhuesi në udhëzimin e tij të instalimit.
- 5.5. Matësi i gazit duhet të ketë një element të testimit i cili do të mundësonte kryerjen e testeve në një kohë të arsyeshme.
- 5.6. Matësi i gazit duhet të respektojë GML-në në çdo drejtim të rrjedhës ose vetëm në një drejtim të rrjedhës së shënuar në mënyrë të qartë.
6. **Njësitë**
- Sasia e matur duhet të paraqitet në metër kub ose në kilogram.

PJESA II KËRKESAT SPECIFIKE

PAJISJET PËR SHNDËRRIMIN E VËLLIMIT

Një pajisje e shndërrimit të vëllimit përbën një nën-montim kur është së bashku me një mjet matës, me të cilin është kompatibil.

Për një pajisje të shndërrimit të vëllimit duhet të zbatohen kërkesat thelbësore për matësit e gazit, nëse është e zbatueshme. Përveç kësaj, duhet të zbatohen edhe kërkesat e mëposhtme:

7. **Kushtet bazë për sasinë e shndërruara**

Prodhuesi duhet t'i specifikojë kushtet bazë për sasinë e shndërruara.

8. **GML**

— 0,5 % në temperaturë të ambientit $20\text{ }^{\circ}\text{C} \pm 3\text{ }^{\circ}\text{C}$, lagështi të ambientit $60\text{ } \% \pm 15\text{ } \%$, vlerat nominale për furnizim me energji;

— 0,7 % për pajisjet për shndërrimin e temperaturës në kushtet e vlerësuara të funksionimit;

— 1 % për pajisjet e tjera të shndërrimit në kushtet e vlerësuara të funksionimit. Shënim:

Gabimi i matësit të gazit nuk është llogaritur.

Pajisja e shndërrimit të vëllimit nuk duhet të shfrytëzojë GML-në ose të favorizoj në mënyrë sistematike ndonjë palë.

9. **Përshtatshmëria**

- 9.1. Një pajisje elektronike e shndërrimit duhet të jetë e aftë për zbulimin, kur ajo është duke vepruar jashtë rangut/rangjeve operativ/e të vendosur nga prodhuesi për parametrat që janë të rëndësishëm për saktësinë e matjes. Në një rast të tillë, pajisja e shndërrimit duhet të ndalojë integrimin e sasisë së shndërruar, dhe mund të totalizojë veçmas sasinë e konvertuar gjatë kohës që vepron jashtë rangut/rangjeve operativ/e.
- 9.2. Një pajisje elektronike e shndërrimit duhet të jetë në gjendje të shfaqë të gjitha të dhënat relevante për matjen, pa pajisje shtesë.

PJESA III

VËNIA NË SHFRYTËZIM DHE VLERËSIMI I KONFORMITETIT

Vënia në shfrytëzim

10. (a) Për përdorimin e matjeve në amvisëri, lejohet që matja e tillë të kryhet me anë të ndonjë mjeti matës që ka klase 1,5 dhe nga klasa 1,0 të cilat kanë një raport Q_{max} / Q_{min} të barabartë ose më të madh se 150.
- (b) Për përdorimin e matjeve në tregti dhe/ose në industri të lehtë, lejohet që matjet e tilla të kryhen nga çdomjet matës që ka klasë 1,5.
- (c) Distributori ose personi i caktuar ligjërisht për instalimin e matësit të gazi duhet të sigurojnë karakteristikat e përcaktuara sipas pikave 1.2 dhe 1.3, në mënyrë që matësi i gazit të jetë i përshtatshëm për matjen e saktë të konsumit që është parashikuar ose është i parashikueshëm.

VLERËSIMI I KONFORMITETIT

Procedurat e vlerësimit të konformitetit të referuara në Nenin 17, mes të cilave prodhuesi mund të zgjedh, janë:

B + F ose B + D ose H1.

SHTOJCA V

NJEHSORËT E ENERGJISË ELEKTRIKE AKTIVE (MI-003)

Kërkesat përkatëse të shtojcës I, kërkesat specifike të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të listuara në këtë shtojcë, zbatohen për njehsorët e energjisë aktive të destinuara për shfrytëzim nga amvisëritë, shfrytëzim komercial dhe për shfrytëzim nga industritë e lehta

Shënim:

Njehsorët e energjisë elektrike mund të përdoren në kombinim me transformatorët-mjet matës të jashtëm, në varësi të teknikës së matjes së aplikuar. Megjithatë, kjo shtojcë mbulon vetëm njehsorët e energjisë elektrike, por jo transformatorët-si mjete matëse.

PËRKUFIZIMET

Njehsori i energjisë elektrike aktive është një pajisje që matë energjinë elektrike aktive që konsumohet në një qark.

I	=	rryma elektrike që rrjedh përmes njehsorit;
I _n	=	rryma e specifikuar referente për të cilë është projektuar njehsori i i operuar nga transformatori;
I _{st}	=	vlera më e ulët deklaruar e I në të cilën njehsori regjistron energjinë elektrike aktive në fuqinë për njësi (njehsori shumëfazor me ngarkesë të balancuar);
I _{min}	=	vlera e I për të cilën gabimi qëndron brenda gabimit maksimal të lejuar (GML) (njehsori shumëfazor me ngarkesë të balancuar);
I _{tr}	=	vlera e I për të cilën gabimi qëndron brenda GML më të vogël që korrespondon me indeksin e klasës të njehsorit;
I _{max}	=	vlera maksimale e I për të cilën gabimi qëndron brenda GML;
U	=	tensioni elektrik që kalon nëpër njehsor;
U _n	=	tensioni i specifikuar referencë;
f	=	frekuenca e tensionit që kalon nëpër njehsor;
f _n	=	frekuenca referencë i specifikuar;
PF	=	faktori i fuqisë = $\cos\phi$ = kosinusi i ndryshimit të fazave ϕ ndërmjet I dhe U.

KËRKESAT SPECIFIKE

1. Saktësia

Prodhuesi duhet të specifikojë indeksin e klasës së njehsorit. Indekset e klasës janë të përcaktuara si: Klasa A, B dhe C.

2. Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Prodhuësi duhet të specifikojë kushtet e vlerësuara funksionale të njehsorit; në veçanti:

Vlerat e f_n , U_n , I_n , I_{st} , I_{min} , I_{tr} dhe I_{max} të cilat zbatohen te njehsori. Për vlerat e specifikuara të rrymës, njehsori duhet të plotësojë kushtet e dhëna në tabelën 1;

Tabela 1

	Klasa A	Klasa B	Klasa C
Për njehsorët e lidhur direkt			
I_{st}	$\leq 0,05 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$
I_{min}	$\leq 0,5 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,5 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,3 \cdot I_{tr}$
I_{max}	$\geq 50 \cdot I_{tr}$	$\geq 50 \cdot I_{tr}$	$\geq 50 \cdot I_{tr}$
Për njehsorët që funksionojnë me transformator			
I_{st}	$\leq 0,06 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,02 \cdot I_{tr}$

	Klasa A	Klasa B	Klasa C	
I_{min}	$\leq 0,4 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,2 \cdot I_{tr} \text{ (1)}$	$\leq 0,2 \cdot I_{tr}$	
I_n	$= 20 \cdot I_{tr}$	$= 20 \cdot I_{tr}$	$= 20 \cdot I_{tr}$	
I_{max}	$\geq 1,2 \cdot I_n$	$\geq 1,2 \cdot I_n$	$\geq 1,2 \cdot I_n$	

(1) Për klasën B do të aplikohen njehsorët elektromekanik $I_{min} \leq 0,4 \cdot I_{tr}$

Rangjet e tensioni, frekuencës dhe faktorit të fuqisë brenda të cilëve njehsori duhet t'i përmbush kërkesat e GML-së, janë specifikuar në Tabelën 2. Këto ndryshime do të njohin karakteristikat tipike të energjisë elektrike të furnizuar nga sistemet publike të shpërndarjes.

Rangjet e tensionit dhe frekuencës do të jenë të paktën:

$$0,9 \cdot U_n \leq U \leq 1,1 \cdot U_n$$

$$0,98 \cdot f_n \leq f \leq 1,02 \cdot f_n$$

Rangjet e faktorit të fuqisë të paktën nga $\cos\phi = 0,5$ induktive deri në $\cos\phi = 0,8$ kapacitive.

3. GML-të

Efektet e sasisë për matje të ndryshme dhe sasi të ndikuese (a, b, c, ...) janë vlerësuar veç e veç, të gjitha sasi të për matjet e tjera dhe sasi të ndikuese mbahen relativisht konstant në vlerat e tyre të referencës. Gabimi i matjes, që nuk duhet të tejkalojë GML-në e pasqyruar në tabelën 2, llogaritet si:

$$\text{Gabimi i matjes} = \sqrt{a^2 + b^2 + c^2 \dots}$$

Kur njehsori vepron nën rrymës e ngarkesës së ndryshueshme, përqindja e gabimeve nuk duhet të tejkalojë kufijtë e dhënë në Tabelën 2.

Tabela 2

Përqindja e GML-së në kushtet e vlerësuar funksionale dhe niveli i rrymës së ngarkesës së përcaktuar dhe temperatura e funksionimit												
	Temperaturat e funksionimit			Temperaturat e funksionimit			Temperaturat e funksionimit			Temperaturat e funksionimit		
	+ 5 °C ... + 30 °C			- 10 °C ... + 5 °C or + 30 °C ... + 40 °C			- 25 °C ... - 10 °C or + 40 °C ... + 55 °C			- 40 °C ... - 25 °C or + 55 °C ... + 70 °C		
Klasa e njehsorit	A	B	C	A	B	C	A	B	C	A	B	C

Njehsori njëfazor; njehsori shumëfazor nëse funksionon me ngarkesë të balancuar

$I_{min} \leq I < I_{tr}$	3,5	2	1	5	2,5	1,3	7	3,5	1,7	9	4	2
---------------------------	-----	---	---	---	-----	-----	---	-----	-----	---	---	---

$I_{tr} \leq I_{\max}$	3,5	2	0,7	4,5	2,5	1	7	3,5	1,3	9	4	1,5
Njehsori shumëfazor nëse funksionon me ngarkesë njëfazore												
$I_{tr} \leq I_{\max}$, shikoni përjashtimin e mëposhtëm	4	2,5	1	5	3	1,3	7	4	1,7	9	4,5	2

Për njehsorët shumëfazor elektromekanik rangu i rrymës për ngarkesën njëfazore është i kufizuar në $5 I_{tr} \leq I_{\max}$

Kur një njehsor funksionon në temperaturë të ndryshme, do të zbatohen vlerat përkatëse të MPE-së. Njehsori nuk do të shfrytëzoj GML-të ose sistematikisht të favorizoj ndonjë palë.

4. Efekti i lejueshëm i çrregullimeve

4.1. Në përgjithësi

Nëse njehsorët e energjisë elektrike janë të lidhur direkt me furnizuesin kryesor dhe nëse rryma kryesore është një nga sasitë për matje, një mjedis i veçantë elektromagnetik përdoret për njehsorët e energjisë elektrike.

Njehsori duhet të përputhet me mjedisin elektromagnetik E2 dhe kërkesat shtesë në pikat 4.2 dhe 4.3.

Mjedisi elektromagnetik dhe efektet e lejuara pasqyrojnë gjendjen në të cilën ka çrregullime për periudha afatgjata të cilat nuk do të ndikojnë në saktësinë përtej vlerave të ndryshimit kritik dhe çrregullimeve kalimtare, të cilat mund të shkaktojnë një degradim ose humbje të përkohshme të funksionit ose performancës, por nga të cilat njehsori duhet të rimëkëmbet dhe nuk do të ndikojë në saktësinë përtej vlerave të ndryshimit kritik.

Kur ekziston një rrezik i lartë i parashikueshëm për shkak të rrufeve apo ku mbizotërojnë rrjetet largpërçuese të furnizimit, karakteristikat metrologjike të njehsorit duhet të mbrohen.

4.2. Efektet e çrregullimeve për periudha të gjata

Tabela 3

Vlerat e ndryshimit kritik për çrregullimet në periudha të gjata			
Çrregullimet	Vlerat e ndryshimit kritik në përqindje për njehsorin e klasës		
	A	B	C
Sekuenca e fazës kthyese	1,5	1,5	0,3
Çekuilibrimi i tensionit (i aplikueshëm vetëm te njehsorët shumëfazor)	4	2	1
Përmbajtja harmonike në qarqet e rrymës ⁽¹⁾	1	0,8	0,5

DC dhe harmonikët në qarqet e rrymës ⁽¹⁾	6	3	1,5
Shpërthimet e shpejta kalimtare	6	4	2
Fushat magnetike; fusha elektromagnetike HF (RF e rrezatuar); Çrregullimet e kryera të shkaktuara nga fushat e radio-frekuencave; dhe imuniteti në oscilimet valore;	3	2	1

(1) Në rastin e njehsorëve elektromekanik të energjisë elektrike, nuk janë përcaktuar vlerat e ndryshimit kritik për përmbajtjen e harmonikëve në qarqet e rrymës DC dhe harmonikët në qarkun e rrymës.

4.3. Efekti i lejuar i dukurive kalimtare elektromagnetike

4.3.1. Efekti i një çrregullimi elektromagnetik në një njehsor të energjisë elektrike do të jetë i tillë që gjatë dhe menjëherë pas një çrregullimi:

— çdo dalje e destinuar për testimin e saktësisë së njehsorit nuk prodhon pulse ose sinjale që korrespondojnë me energjinë për më shumë se vlera e ndryshimit kritik,

dhe në një kohë të arsyeshme pas çrregullimit njehsori:

— do të rimëkëmbet për të operuar brenda kufijve të GML-ve, dhe

— do të mbroj të gjitha funksionet e matjes, dhe

— do të lejojë rimëkëmbjen e të gjitha të dhënave të matjes të pranishme përpara çrregullimit, dhe

— nuk do të tregojë ndryshim në energjinë e regjistruar më të madhe se vlera e ndryshimit kritik.

Vlera e ndryshimit kritik në kEh është $m \cdot U_n \cdot I_{\max} \cdot 10^{-6}$

(m është numri i elementeve matëse të njehsorit, U_n në Volt dhe $I_{\max}$ në Amper).

4.3.2. Për mbingarkesë të rrymës vlera e ndryshimit kritik është 1,5 %.

5. Përshtatshmëria

5.1. Nën tensionin e vlerësuar funksional, gabimi pozitiv i njehsorit nuk duhet të kalojë 10%.

5.2. Ekran i energjisë së përgjithshme duhet të ketë një numër të mjaftueshëm të shifrave për të siguruar që, kur njehsori funksionon me 4000 orë në ngarkesë të plotë ($I = I_{\max}$, $U = U_n$ dhe $PF = 1$) treguesi të mos kthehet në vlerën e tij fillestare dhe nuk do të jetë në gjendje për tu resetuar gjatë përdorimit.

5.3. Në rast të humbjes së energjisë elektrike në qark, sasi e energjisë elektrike të matur duhet të mbeten në dispozicion për tu lexuar gjatë një periudhe prej të paktën 4 muaj.

5.4. *Funksionimi pa ngarkesë*

Kur tensioni aplikohet pa rrjedhje të rrymës në qarkun e rrymës (qarku i rrymës duhet të jetë qark i hapur), njehsori nuk duhet të regjistrojë energjinë në çfarëdo tensioni në mes të $0,8 \cdot U_n$ dhe $1,1 \cdot U_n$.

5.5. *Fillimi*

Njehsori duhet të filloj dhe vazhdoj të regjistroj në U_n , $PF = 1$ (njehsori shumëfazor me ngarkesa të balancuara) në rrymën e cila është e barabartë me I_{st} .

6. Njësiti

Energjia elektrike e matur duhet të shfaqet në kilovat-orë ose në megavat-orë.

7. Vënia në përdorim

(a) Për matjen e energjisë elektrike në amvisëri, do të lejohet që matjet e tilla të kryhen përmes çdo njehsori të klasës A. Për qëllime të caktuara, do të lejohet që të përdoret çfarëdo njehsori i klasës B.

(b) Për matjen e energjisë elektrike për përdorime komerciale dhe/ose industrinë e lehtë do të lejohet që matjet e tilla të kryhen nga çdo njehsori i klasës B. Për qëllime të caktuara, do të lejohet që të përdoret çfarëdo njehsori i klasës C.

(c) Rangu i rrymës përcaktohet nga distributori ose personi i caktuar ligjërisht për instalimin e njehsorit, në mënyrë që njehsori të jetë i përshtatshëm për matjen e saktë të konsumit që është parashikuar ose i parashikueshëm.

VLERËSIMI I KONFORMITETIT

Procedurat e vlerësimit të konformitetit të përmendura në nenin 17, prej të cilave prodhuesi mund të zgjedh janë : B + F ose B + D ose H1.

SHTOJCA VI

NJEHSORËT E ENERGJISË TERMIKE (MI-004)

Kërkesat përkatëse të shtojcës I, kërkesat specifike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të listuara në këtë shtojcë, zbatohen për njehsorët e energjisë termike të definuar më poshtë, të destinuara për shfrytëzim nga amvisëritë, shfrytëzim komercial dhe për shfrytëzim nga industritë e lehta

PËRKUFIZIMET

Njehsori i energjisë termike është një mjet matës i projektuar për të matur energjinë termike, e cila në një qark të shkëmbimit të energjisë termike, jepet nga një lëng i quajtur lëngu i përcjelljes së energjisë termike.

Një njehsor i energjisë termike është një mjet matës i plotë ose një mjet matës i kombinuar që përbëhet nga nën-montimet, sensori i rrjedhjes, një palë sensorësh⁹ të temperaturës, dhe kalkulatori, siç përcaktohet në nenin 4 (2), ose një kombinim i tyre.

ϑ	=	temperatura e lëngut përcjellës të energjisë termike;	
ϑ_{in}	=	vlera e ϑ në hyrjen e qarkut të shkëmbimit të energjisë termike;	
ϑ_{out}	=	vlera e ϑ në daljen e qarkut të shkëmbimit të energjisë termike;	
$\Delta\vartheta$	=	ndryshimi i temperaturës $\vartheta_{in} - \vartheta_{out}$ me $\Delta\vartheta \geq 0$;	
ϑ_{max}	=	kufiri i epërm i ϑ që njehsori i energjisë termike të funksionoj si duhet brenda MPE-ve;	
ϑ_{min}	=	kufiri i poshtëm i ϑ që njehsori i energjisë termike të funksionoj si duhet brenda MPE-ve;	
$\Delta\vartheta_{max}$	=	kufiri i epërm i $\Delta\vartheta$ që njehsori i energjisë termike të funksionoj si duhet brenda MPE-ve;	
$\Delta\vartheta_{min}$	=	kufiri i poshtëm i $\Delta\vartheta$ që njehsori i energjisë termike të funksionoj si duhet brenda MPE-ve;	
q	=	shkalla e rrjedhës së lëngut përcjellës të energjisë termike;	
q_s	=	vlera më e lartë e q që është e lejuar për periudha të shkurtra kohore që njehsori i energjisë termike të funksionoj si duhet;	
q_p	=	vlera më e lartë e q që është e lejuar përgjithmonë, që njehsori i energjisë termike të funksionoj si duhet;;	
q_i	=	vlera më e ulët e q që është e lejuar që njehsori i energjisë termike të funksionoj si duhet;	
P	=	fuqia termike e shkëmbimit të energjisë termike;	
P_s	=	kufiri i sipërm i P që është i lejuar që njehsori i energjisë termike të funksionoj si duhet.	

KËRKESAT SPECIFIKE

1. Kushtet e vlerësuarat të funksionimit

Vlerat e kushteve të vlerësuarat të funksionimit do të specifikohet nga prodhuesi si më poshtë:

1.1. Për temperaturën e lëngut: $\vartheta_{\max}$, $\vartheta_{\min}$,

— Për ndryshimet e temperaturës: $\Delta\vartheta_{\max}$, $\Delta\vartheta_{\min}$,

subjekt i kufizimeve të mëposhtme: $\Delta\vartheta_{\max}/\Delta\vartheta_{\min} \geq 10$; $\Delta\vartheta_{\min} = 3 \text{ K}$ ose 5 K ose 10 K .

1.2. Për shtypjen e lëngut: shtypja e brendshme maksimale pozitive që njehsori i energjisë termike mund ta përballojë në mënyrë të përhershme në kufirin e epërm të temperaturës.

1.3. Për shkallën e rrjedhjes së lëngut: q_s , q_p , q_i , ku vlerat e q_p dhe q_i janë subjekt i kufizimeve të mëposhtme: $q_p/q_i \geq 10$.

1.4. Për fuqinë termike: P_s .

2. Klasat e saktësisë

Klasat e mëposhtme të saktësisë janë definuar për njehsorët e energjisë termike: 1, 2, 3.

3. GML-të e zbatueshme për njehsorët e kompletuar të energjisë termike

Gabimet relative maksimale të lejueshme të zbatueshme në një njehsor të kompletuar të energjisë termike, të shprehur në përqindje të vlerës së vërtetë për çdo klasë të saktësie, janë:

— Për klasën 1: $E = E_f + E_t + E_c$, me E_f , E_t , E_c sipas pikave 7.1 deri në 7.3.

— Për klasën 2: $E = E_f + E_t + E_c$, me E_f , E_t , E_c sipas pikave 7.1 deri në 7.3.

— Për klasën 3: $E = E_f + E_t + E_c$, me E_f , E_t , E_c sipas pikave 7.1 deri në 7.3.

Njehsori i kompletuar i energjisë termike nuk do të shfrytëzoj GML-të ose sistematikisht të favorizoj ndonjë palë.

4. Ndikimet e lejuara të çrregullimeve elektromagnetike

4.1. Mjeti matës nuk duhet të ndikohet nga fushat magnetike statike dhe fushat elektromagnetike në frekuencën e rrjetit.

4.2. Ndikimi i një çrregullimi elektromagnetik do të jetë i tillë që ndryshimi në rezultatin e matjes nuk është më i madh se vlera e ndryshimit kritik ashtu si përcaktohet në kërkesën 4.3 ose treguesi i rezultatit të matjes është i tillë që nuk mund të interpretohet si rezultat i vlefshëm.

4.3. Vlera e ndryshimit kritik për një njehsor të kompletuar të energjisë termike është e barabartë me vlerën absolute të GML-së që aplikohet në atë njehsor të energjisë termike (shih pikën (3)).

5. Qëndrueshmëria

Pas kryerjes së një testi të përshtatshëm, duke marrë parasysh periudhën kohore të vlerësuar nga prodhuesi, do të plotësohen kriteret e mëposhtme:

5.1. Sensorët e rrjedhës: ndryshimi i rezultatit të matjes pas testit të qëndrueshmërisë kur krahasohet me rezultatin e matjes fillestare, nuk duhet të kalojë vlerën e ndryshimit kritik.

5.2. Sensorët e temperaturës: ndryshimi i rezultatit të matjes pas testit të qëndrueshmërisë kur krahasohet me rezultatin e matjes fillestare, nuk duhet të kalojë 0,1 °C.

6. Mbishkrimet në një njehsor të energjisë termike

— Klasa e saktësisë

— Kufijtë e shkallës së rrjedhës

— Kufijtë e temperaturës

— Kufijtë e ndryshimit të temperaturës

— Vendi i instalimit të sensorit të rrjedhës: rrjedha ose kthimi

— Treguesi i drejtimit të rrjedhës

7. Nën-sistemet

Dispozitat për nën-montimet mund të aplikohen për nën-montimet e prodhuara nga prodhuesit e njëjtë ose të ndryshëm. Kur një njehsor i energjisë termike përbëhet nga nën-montimet, kushtet esenciale për njehsorin e energjisë termike zbatohen për nën-montimet si relevante. Përveç kësaj, do të zbatohen si më poshtë:

7.1. MPE-të relative të sensorit të rrjedhës, e shprehur në %, për klasat e saktësisë:

— Klasa 1: $E_f = (1 + 0,01 \text{ qp/q})$, por jo më shume se 5 %,

— Klasa 2: $E_f = (2 + 0,02 \text{ qp/q})$, por jo më shume se 5 %,

— Klasa 3: $E_f = (3 + 0,05 \text{ qp/q})$, por jo më shume se 5 %,

ku gabimi E_f ndërlihd vlerën e paraqitur me vlerën e vërtetë të marrëdhënieve në mes të sinjalit të sensorit të rrjedhës dalëse dhe masës apo vëllimit.

7.2. GML-të relative të palës së sensorëve të temperaturës, i shprehur në %:

— $E_t = (0,5 + 3 \cdot \Delta\vartheta_{\min}/\Delta\vartheta)$,

ku gabimi E_t ndërlidh vlerën e paraqitur me vlerën e vërtetë të marrëdhënieve në mes të çiftit të sensorëve të temperaturës dalëse dhe ndryshimit të temperaturës.

7.3. GML-të relative të llogaritësit, të shprehura në %:

$$— E_c = (0,5 + \Delta\vartheta_{\min}/\Delta\vartheta),$$

ku gabimi E_c ndërlidh vlerën e energjisë termike të treguar me vlerën e vërtetë të energjisë termike.

7.4. Vlera e ndryshimit kritik për një nën-montim të njehsorit të energjisë termike është e barabartë me vlerën përkatëse absolute të GML-ve të zbatueshme për nën-montime (shih pikat 7.1, 7.2 ose 7.3).

7.5. Mbishkrimet në nën-montime

Sensori i rrjedhës:	Klasa e saktësisë
	Kufijtë e shkallës së rrjedhës
	Kufijtë e temperaturës
	Faktori nominal i njehsorit (p.sh. litrat/pulset) ose sinjali dalës përkatës
	Treguesi drejtimit të rrjedhës
Çifti i sensorëve të temperaturës:	Identifikimi i llojit (p.sh. P_t 100)
	Kufijtë e temperaturës
	Kufijtë e ndryshimit të temperaturës
Llogaritësi:	Lloji i sensorëve të temperaturës
	— Kufijtë e temperaturës
	— Kufijtë e ndryshimit të temperaturës
	— Faktori nominal i kërkuar i njehsorit (p.sh. litrat/pulset) ose sinjali hyrës korespondues nga sensor i rrjedhës
	— Vendi i instalimit të sensorit të rrjedhës: rrjedha ose kthimi

VËNIA NË PËRDORIM

8. (a) Për matjet për përdorim në amvisëri, lejohet që matjet e tilla të kryhen nga çdo njehsor i klasës 3.
- (b) Për matjet për përdorime komerciale dhe/ose industrinë e lehtë, lejohet që të përdoret njehsor të klasës 2.
- (c) Sa i përket kërkesave të pikës 1.1 deri në 1.4, distributori ose personi i caktuar ligjërisht për instalimin e njehsorit përcakton karakteristikat, në mënyrë që njehsori të jetë i përshtatshëm për matjen e saktë të konsumit që është parashikuar ose e parashikueshme.

VLERËSIMI I KONFORMITETIT

Procedurat e vlerësimit të konformitetit të përmendura në nenin 17, prej të cilave prodhuesi mund të zgjedh janë:

B + F ose B + D ose H1.

SHTOJCA VII

SISTEMET MATËSE PËR MATJEN E VAZHDUESHME DHE DINAMIKE TË SASIVE TË LËNGJEVE PËRVEÇ UJIT (MI-005)

Kërkesat përkatëse thelbësore të shtojcës I, kërkesat specifike të kësaj shtojce dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të listuara në këtë shtojcë, zbatohen për sistemet e matjes së destinuar për matjen e vazhdueshme dhe dinamike të sasive (vëllimt apo masat) të lëngjeve përveç ujit. Kur është e mundur, termat 'vëllimi, dhe L' në këtë shtojcë mund të lexohen si: 'masë dhe kg'.

PËRKUFIZIMET

Njehsor	Një mjet matës i projektuar për të matur vazhdimisht, për të ruajtur informacionin dhe për të shfaqur sasinë në kushtet e matjes së lëngjeve që rrjedhin përmes shndërruesit të matjes në një gyp të mbyllur të mbushur plotësisht.	
Llogaritësi	Pjesë e njehsorit që merr sinjalet e daljes nga shndërruesi (t) e matjes dhe ndoshta, nga mjete matëset matëse të shoqëruara dhe shfaq rezultatet e matjes.	
Mjete matëset matëse të shoqëruara	Një mjet matës i lidhur me llogaritësin për matjen e sasive të caktuara të cilat janë karakteristike e lëngut, me qëllim për të bërë një korrigjim dhe / ose konvertim.	
Pajisja e konvertimit	Pjesa e llogaritësit e cila merr parasysh karakteristikat e lëngut (temperaturën, dendësinë, etj) të matur duke përdorur mjete matëset matëse të shoqëruara, ose e memorizuar, automatikisht konverton: — vëllimin e lëngut të matur në kushtet e matjes brenda vëllimit në kushte themelore dhe/ose në masë, ose — masa e lëngut e matur në kushte të matjes në vëllim në kushte të matjes dhe / ose në një vëllim në kushte themelore shënim: Pajisja e konvertimit përfshin mjete matëset përkatëse të matjes.	
Kushtet themelore	Kushtet specifike në të cilat sasia e matur e lëngut është konvertuar në kushtet e matjes.	
Sistemi matës	Një sistem që përfshin vetë njehsorin dhe të gjitha pajisjet e nevojshme për të siguruar matje të sakta ose të destinuara për të lehtësuar veprimet matëse.	
Aparati për mbushjen me karburant	Një sistem matës i destinuar për furnizimin me karburant të mjeteve motorike, anijeve të vogla dhe aeroplanëve të vegjël.	
Arranzhimi i vetë-shërbimi	Një aranzhim që i mundëson konsumatorëve që të përdorin një sistem matës me qëllim të mbushjes me lëng për përdorim vetanak.	

Pajisje për vetë-shërbim	Një pajisje e veçantë që është pjesë e aranzhimit të vetë-shërbimit dhe e cila lejon një nga shumë sistemet matëse që të kryej vetë-shërbim.	
Sasia minimale e matur (SMM)	Sasia më e vogël e lëngut për të cilën matja është metrologjikisht e pranueshme për sistemin matës.	
Tregues direkt	Treguesi, qoftë vëllimi ose masa, që korrespondon me matjen dhe se njësia matëse është në gjendje të duhur fizike për matje. Shënim: Treguesi direkt mund të konvertohet në një sasi tjetër duke përdorur një pajisje të konvertimit.	
Të ndërprera/të pandërprera	Një sistem matës konsiderohet si i ndërprerë / i pandërprerë kur rrjedha e lëngut mund / nuk mund të ndalet lehtë dhe shpejtë.	
Rangu i rrjedhës	Rangu ndërmjet shkallës minimale të rrjedhës ($Q_{\min}$) dhe shkallës maksimale të rrjedhës ($Q_{\max}$).	

KËRKESAT SPECIFIKE

1. Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Prodhuesi duhet të specifikojë kushtet e vlerësuara të funksionimit të mjetit matës, në mënyrë të veçantë;

1.1. Rangu i rrjedhës

Rangu i rrjedhës i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

(i) Rangu i rrjedhës të sistemit matës duhet të jetë brenda rangut të rrjedhës të secilit prej elementeve të tij, në veçanti njehsori.

(ii) Njehsori dhe sistemi matës:

Tabela 1

Sistemi specifik matës	Karakteristikat e lëngut	Raporti minimal i $Q_{\max}$: $Q_{\min}$
Aparati për mbushjen me karburant	Gazrat e pa lëngëzuara	10: 1
	Gazra e lëngëzuara	5: 1
Sistemi matës	Lëngje kriogjenike	5: 1
Sistemet matëse në gazsjellës dhe sistemet për ngarkimin e anijeve	Të gjitha lëngjet	I përshtatshëm për përdorim
Të gjitha sistemet tjera matëse	Të gjitha lëngjet	4: 1

1.2. Karakteristikat e lëngut që do të matet nga mjetit matës duke specifikuar emrin ose llojin e lëngut apo karakteristikat e tij përkatëse, për shembull:

— Rangu temperaturor;

— Rangu i shtypjes;

— Rangu i dendësisë;

— Rangu i viskozitetit.

1.3. Vlera nominale e furnizimit të tensionit AC dhe / ose kufijtë e furnizimit të tensionit DC.

1.4. Kushti themelor për vlerat e konvertuara është 15°C.

2. **Klasifikimi i saktësisë dhe gabimet maksimale të lejuara (GML)**

2.1. Për sasitë e barabarta ose më të mëdha se 2 litra, GML-të e treguesit janë:

Tabela 2

	Klasa e saktësisë				
	0,3	0,5	1,0	1,5	2,5
Sistemet matëse (A)	0,3 %	0,5 %	1,0 %	1,5 %	2,5 %
Njehsorët (B)	0,2 %	0,3 %	0,6 %	1,0 %	1,5 %

(¹) OJ L 283, 31.10.2003, p. 51.

2.2. Për sasitë më pak se dy litra, GML-të e treguesit janë:

Tabela 3

Vëllimi i matur V	GML
$V < 0,1 \text{ l}$	$4 \times$ vlera në tabelën 2, aplikohet deri në 0,1 L
$0,1 \text{ l} \leq V < 0,2 \text{ l}$	$4 \times$ vlera në tabelën 2
$0,2 \text{ l} \leq V < 0,4 \text{ l}$	$2 \times$ vlera në tabelën 2, aplikohet deri në 0,4 L
$0,4 \text{ l} \leq V < 1 \text{ l}$	$2 \times$ vlera në tabelën 2
$1 \text{ l} \leq V < 2 \text{ l}$	Vlera në tabelën 2, aplikohet deri në 2 L

2.3. Megjithatë, pa marrë parasysh se çfarë mund të jetë sasia e matur, magnituda e GML-së jepet nga vlera më e madhe midis dy vlerave të mëposhtme:

— Vlera absolute e GML-së të dhënë në tabelën 2 ose tabelën 3,

— Vlera absolute e GML-së për sasinë minimale të matur ($E_{\min}$).

2.4.1. Për sasitë minimale të matura më të mëdha ose të barabartë me 2 litra, do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

Kushti 1

$E_{\min}$ duhet të plotësoj kushtin: $E_{\min} \geq 2 R$, ku R është intervali i shkallës më të vogël i pajisjes treguese.

Kushti 2

$E_{\min}$ jepet nga formula: $E_{\min} = (2MMQ) \times (A/100)$, ku:

- SMM (MMQ) është sasia minimale e matur,
- A, është vlera numerike e specifikuar në pikën A të tabelës 2.

2.4.2. Për sasinë minimale të matur më të vogël se dy litra, kushti 1 i përmendur më lart zbatohet dhe E_{min} është dyfishi i vlerës së specifikuar në Tabelën 3, dhe i lidhur me pikën A në tabelën 2.

2.5. *Treguesi i konvertuar*

Në rastin e treguesit të konvertuar, GML-të janë si në pikën A të tabelës 2.

2.6. *Pajisjet e konvertimit*

GML-të në treguesit e konvertimit për shkak të pajisjes së konvertimit janë të barabartë me ± (A — B), A dhe B janë vlerat e specifikuara në tabelën 2.

Pjesët e pajisjeve të konvertimit që mund të testohen veç e veç

(a) Llogaritësi

GML-të në sasinë e treguesve të lëngut të zbatueshme në llogaritje, pozitive apo negative, janë të barabartë me një të dhjetën e GML-ve të përcaktuara në pikën A të tabelës 2.

(b) Mjete matëset matëse të shoqëruara

Mjete matëset matëse të shoqëruara duhet të kenë saktësi të paktën po aq mirë sa vlerat në tabelën 4:

Tabela 4

GML në matje	Klasat e saktësisë së sistemit matës				
	0,3	0,5	1,0	1,5	2,5
Temperatura	± 0,3 °C	± 0,5 °C			± 1,0 °C

MPE në matje	Klasat e saktësisë së sistemit matës				
	0,3	0,5	1,0	1,5	2,5
Shtypja	Më pak se 1 MPa: ± 50 kPa Nga 1 deri në 4 MPa: ± 5 % Mbi 4 MPa: ± 200 kPa				
Dendësia	± 1 kg/m ³		± 2 kg/m ³		± 5 kg/m ³

Këto vlera aplikohen në treguesit e sasive karakteristike të lëngut të shfaqur në pajisjen e konvertimit.

(c) Saktësia për funksionin e llogaritjes

GML-të në llogaritjen e çdo karakteristike të sasisë së lëngut, pozitive apo negative, është e barabartë me dy të pestat e vlerës së caktuar në (b).

2.7. Kërkesa (a) në pikën 2.6 zbatohet për çdo llogaritje, jo vetëm konvertim.

2.8. Sistemi i matjes nuk do të shfrytëzoj GML-të ose sistematikisht të favorizoj ndonjë palë.

3. Efekti maksimal i lejuar i çrregullimeve

3.1. Efekti i një çrregullimi elektromagnetik në një sistem matës, do të jetë njëri nga më poshtë:

— Ndryshimi në rezultatin e matjes nuk është më e madhe se vlera e ndryshimit kritik siç përcaktohet në pikën 3.2, ose

— Treguesi i rezultatit të matjes tregon një ndryshim të çastit që nuk mund të interpretohet, memorizohet ose të transmetohet si rezultat matës. Për më tepër, në rastin e një sistemi me ndërprerje, kjo mund të nënkuptoj edhe pamundësinë për të kryer ndonjë matje, ose

— Ndryshimi në rezultatin e matjes është më e madhe se vlera e ndryshimit kritik, rast në të cilin sistemi i matjes do të lejojë nxjerrjen e rezultatit matës vetëm para se të ndodh vlera e ndryshimit kritik dhe të ndërpret rrjedhën.

3.2. Vlera e ndryshimit kritik ndryshimi më i madh i GML/5 për një sasi të caktuar të matur ose $E_{\min}$.

4. Qëndrueshmëria

Pas kryerjes së një testi të përshtatshëm, duke marrë parasysh periudhën kohore të vlerësuar nga prodhuesi, do të plotësohet kriteri i mëposhtëm:

Ndryshim i rezultatit të matjes pas testit të qëndrueshmërisë, në krahasim me rezultatin e matjes fillestare, nuk do të tejkalojë vlerën për njësinë matëse të përcaktuar në pikën B të tabelës 2.

5. Përshtatshmëria

5.1. Për çdo sasi të matur në lidhje me të njëjtën matje, treguesit e ofruar nga pajisjet e ndryshme nuk duhet të devijojnë nga njëri-tjetri më shumë se një interval i shkallës kur pajisjet kanë të njëjtën interval të shkallës. Në rastin kur pajisjet kanë intervale të ndryshme të shkallës, devijimi nuk duhet të jetë më shumë se ajo e intervalit më të lartë të shkallës.

Megjithatë, në rastin e një aranzhimit të një vetë-shërbimi, intervali i shkallës së pajisjes treguese kryesore në sistemin matës dhe intervaleve të shkallës të pajisjes së vetë-shërbimit duhet të jetë e njëjtë, dhe rezultatet e matjes nuk do të devijojnë nga njëri-tjetri.

5.2. Nuk duhet të lejohet që të devijohet sasia e matur në kushte normale të përdorimit, vetëm nëse është lehtë e dukshme.

5.3. Çdo përqindje e ajrit ose gazit që nuk vërehet lehtë në lëng, nuk duhet të çojë në një ndryshim të gabimit më të madh se:

— 0,5 % për lëngje përveç lëngjeve të pijshme dhe për lëngje me viskozitet që nuk tejkalon 1 mPa.s, ose

— 1 % për lëngje të pijshme dhe për lëngje me viskozitet që tejkalon 1 mPa.s.

Megjithatë, ndryshimi i lejuar nuk duhet asnjëherë të jetë më i vogël se 1% i MMQ. Kjo vlerë aplikohet në rastin e xhепave të ajrit ose gazit.

5.4. *Mjete matëset për shitje direkte*

5.4.1. Sistemi për matjen e shitjeve direkt duhet të pajiset me mënyrën e resetimit të ekranit në zero.

Nuk duhet të lejohet devijimi i sasisë së matur.

5.4.2. Ekranet në sasisë në të cilën bazohet transaksioni duhet të jetë permanent, derisa të gjitha palët në transaksion e kanë pranuar rezultatin e matjes.

5.4.3. Sistemet matëse për shitjet direkte duhet të jenë me ndërprerje.

5.4.4. Çdo përqindje e ajrit ose gazit në lëng nuk duhet të çojë në ndryshim të gabimit më të madhe se vlerat e përcaktuara në pikën 5.3.

Aparati për mbushjen me karburant

5.4.5. Ekranet në aparatet për mbushjen me karburant nuk duhet të kenë mundësi të resetohen gjatë matjes.

5.4.6. Fillimi i një matje të re nuk duhet mundësohet deri sa ekranet të jetë rikthyer (resetuar) në zero.

5.4.7. Kur një sistem matës është i pajisur me një ekran të çmimeve, diferenca ndërmjet çmimit të treguar dhe çmimit të llogaritur prej njësisë së çmimit dhe sasisë së treguar nuk duhet të tejkalojë çmimin që korrespondon me E_{min} . Megjithatë ky ndryshim nuk duhet të jetë më pak se vlera më e vogël monetare

6. Dështimi i furnizimit me energji

Sistemi i matjes ose duhet të pajiset me një pajisje emergjente të furnizimit me energji që do të mbrojë të gjitha funksionet matëse gjatë dështimit të pajisjes kryesore të furnizimit me energji ose të jetë i pajisur me mënyra për të ruajtur dhe shfaqur të dhënat aktuale në mënyrë që të lejojë përfundimin e transaksionit në progres dhe me mënyra për të ndaluar rrjedhën në momentin e dështimit të pajisjes kryesore të furnizimit me energji.

7. Vënia në përdorim

Tabela 5

Klasa e saktësisë	Llojet e sistemit matës
0,3	Sistemet e matjes në gypa
0,5	Të gjitha sistemet matëse, nëse nuk përcaktohen ndryshe diku tjetër në këtë tabelë, në mënyrë të veçantë: — aparatet për mbushjen me karburant (jo për gazra të lëngëzuara), — sistemet matëse për cisternat rrugore për lëngje me viskozitetit të ulët (< 20 mPa.s) — sistemet matëse për ngarkimin/shkarkimin e anijeve dhe cisternave hekurudhore dhe rrugore ⁽¹⁾ — sistemet matëse për qumësht
1,0	Sistemet e gazrave të lëngëzuara nën presion, të matur në një temperaturë të barabartë ose mbi – 10 °C Sistemet e matjes zakonisht në klasën 0,3 ose 0,5 por që përdoren për lëngjet — temperatura e të cilit është më pak se – 10 °C ose më e madhe se 50 °C — viskoziteti dinamik i të cilit është më i lartë se 1 000 mPa.s — shkalla e rrjedhës maksimal vëllimore i të cilit nuk është më i lartë se 20 L/h
1,5	Sistemet për matjen e dioksidit të karbonit të lëngëzuar Sistemet e matjes për gazrat e lëngëzuara nën presion të matur në temperaturën nën – 10 °C (përveç lëngjeve kirogjenike)
2,5	Sistemet matëse për lëngjet kirogjenike(temperatura nën – 153 °C)

(¹) Megjithatë, në Republikën e Kosovës do të aplikohen sisteme matëse klasës së saktësisë 0,3 ose 0,5 kur përdoret për caktimin e karakteristikave për vajrat minerale kur ngarkohen/shkarkohen anijet dhe cisternat hekurudhore dhe rrugore.

Shënim: Megjithatë, prodhuesi mund të specifikojë një saktësi më të mirë për një lloj të caktuar të sistemit matës.

Njësitë e matjes

Sasia e matur duhet të shfaqet në mililitër, centimetër kub, litër, metër kub, gram, kilogram apo ton.

VLERËSIMI I KONFORMITETIT

Procedurat e vlerësimit të konformitetit të përmendura në nenin 17, prej të cilave prodhuesi mund të zgjedh, janë :

B + F ose B + D ose H1 ose G.

SHTOJCA VIII

PESHORET AUTOMATIKE (MI-006)

Kërkesat thelbësore relevante të Shtojcës I, kërkesat specifike të kësaj Shtojce dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të listuara në Kapitullin I të kësaj Shtojce, zbatohen për mjete matëset automatike për peshim të përcaktuara më poshtë, të destinuara për të përcaktuar masën e një trupi duke përdorur veprimin e gravitetit në atë trup.

PËRKUFIZIMET

Peshorja automatike	Një mjet matës që përcakton masën e një produkti pa ndërhyrjen e një operatori dhe ndjek një program të paracaktuar të proceseve automatike, karakteristike për mjetin matës.
Peshorja automatike sortuese (Automatic catchëigher)	Një peshore automatike që përcakton masën diskrete të ngarkesave të para-paketuara (para paketimit) ose ngarkesave të vetme të materialit refuz (të pa paketuar).
Peshorja automatike kontrolluese (Automatic checkëigher)	Një kontrollues automatik i peshës që ndan artikujt e masave të ndryshme në dy ose më shumë nëngrupe sipas vlerës së diferencës së masës së tyre dhe të një pike të caktuar nominale.
Etiketuesi i peshës	Një kontrollues automatik i peshës që etiketon artikujt individual me vlerën e peshës.
Etiketuesi i peshës/çmimit	Një kontrollues automatik i peshës që etiketon artikujt individual me vlerën e peshës dhe me informata mbi çmimin.
Mjeti matës automatik gravimetrik për mbushje	Një peshore automatike që mbush kontejnerët me një masë të paracaktuar dhe pothuajse konstante të produktit të jo paketuar (refuz)
Totalizatorët me ndërprerje (totalising hopper ëigher)	Një peshore automatike që përcakton masën refuz, duke e ndarë atë në ngarkesa të veçanta. Masa e çdo ngarkese të veçantë përcaktohet në sekuenca dhe përmblihdhet. Çdo ngarkesë e veçantë dorëzohet pastaj tek bulk.
Totalizatori pa ndërprerje	Një peshore automatike që përcakton vazhdimisht masën e një produkti refuz në një rrip transportues, pa nënndarje sistematike të produktit dhe pa ndërprerë lëvizjen e rripit transportues.
Peshorja për matjen e mjeteve hekurudhore	Një peshore automatike që ka një receptor të ngarkesës, që përfshinë binarët për transportimin e mjeteve hekurudhore.

KËRKESAT SPECIFIKE

KAPITULLI I

Kërkesat e përbashkëta për të gjitha llojet peshoreve automatike

1. Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Prodhuesi duhet të specifikojë kushtet e vlerësuara të funksionimit të mjetit matës, si më poshtë:

1.1. Për sasinë që duhet të matet dhe:

Rangun matës sa i përket kapacitetit të tij maksimal dhe minimal.

1.2. Për sasi të influencuese të furnizimit me energji elektrike:

Në rast të furnizimit të tensionit AC	:	Furnizimit nominal i tensionit AC, ose kufijtë e tensionit AC.
Në rast të furnizimit të tensionit DC	:	Furnizimi nominal dhe minimal i tensionit DC, apo kufijtë e tensionit DC.

1.3. Për sasi të influencuese mekanike dhe klimatike:

Rangu i temperaturës minimale është 30°C, përveç nëse është specifikuar ndryshe në kapitujt vijues të kësaj Shtojce.

Klasat e mjedisit mekanik sipas Shtojcës I, pika 1.3.2 nuk janë të zbatueshme. Për mjetet matëse që përdoren nën presion të veçantë mekanik, p.sh. mjetet matëse të inkuorporuara në automjete, prodhuesi duhet t'i përcaktoj kushtet mekanike të përdorimit.

- 1.4. Për sasitë tjera influencuese (nëse është e zbatueshme): Shkalla/shkallët e funksionimit.

Karakteristikat e produktit/produkteve që do të peshohen.

2. **Ndikimi i lejueshëm i çrregullimeve — Mjedisi elektromagnetik**

Performanca e kërkuar dhe vlera kritike e ndryshimit janë dhënë për secilin lloj të mjetit matës, në kapitullin relevant të kësaj Shtojce.

3. **Përshtatshmëria**

- 3.1. Duhet të sigurohen mënyrat për të kufizuar efektet e animit, ngarkimit dhe shkallës së operimit, në atë mënyrë që gabimet maksimale të lejueshme (GML-të) nuk tejkalohen gjatë funksionimit normal.
- 3.2. Objektet e duhura për trajtimin e materialit duhet të sigurohen për të mundësuar që mjeti matës të respektojë GML-të gjatë funksionimit normal.
- 3.3. Çdo ndërfaqe e kontrollit nga operatori duhet të jetë e qartë dhe efektive.
- 3.4. Integriteti i ekranit (ku është i pranishëm) duhet të jetë i verifikueshëm nga operatori.
- 3.5. Duhet të ofrohet aftësi e duhur e paracaktimit zero për të mundësuar mjetin matës të respektojë GML-të gjatë funksionimit normal.
- 3.6. Çdo rezultat jashtë rangut të matjes duhet të identifikohet si i tillë, aty ku është i mundur një printim.

4. **Vlerësimi i konformitetit**

Procedurat e vlerësimit të konformitetit të referuara në Nenin 17, mes të cilave prodhuesi mund të zgjedh, janë: Për sistemet mekanike:

B + D ose B + E ose B + F ose D1 ose F1 ose G ose H1. Për mjete matëset elektromekanike:

B + D ose B + E ose B + F ose G ose H1.

Për sistemet elektronike apo sistemet që përmbajnë softuer: B + D ose B + F ose G ose H1.

KAPITULLI II

Peshoret automatike kontrolluese

1. **Klasat e saktësisë**

- 1.1. Mjete matëset janë të ndara në kategori primare, të caktuara nga:

X ose Y

siç është specifikuar nga prodhuesi.

- 1.2. Këto kategori primare më tej ndahen në katër klasa të saktësisë:

XI, XII, XIII & XIII

dhe

Y(I), Y(II), Y(a) & Y(b)

të cilat duhet të specifikohen nga prodhuesi.

2. Mjete matëset e kategorisë X

2.1. Kategoria X zbatohet për mjete matëset e përdorura për të kontrolluar parapaketimet e bëra në përputhje me kërkesat e Rregullores së Këshillit 76/211/EEC e 20 janarit 1976 mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me bërjen, sipas peshës apo vëllimit, e disa produkteve të parapaketuara (1) të zbatueshme tek paketimet.

2.2. Klasat e saktësisë plotësohen nga një faktor (x) që përcakton sasinë e devijimit të lejuar standard maksimal, siç është specifikuar në pikën 4.2.

Prodhuesi duhet të specifikojë faktorin (x), ku (x) duhet të jetë ≤ 2 dhe në formën e $1 \times 10k$, $2 \times 10k$ ose $5 \times 10k$, ku k është një numër i plotë negativ apo zero.

3. Mjete matëset e kategorisë Y

Kategoria Y zbatohet tek të gjithë kontrolluesit e tjerë automatik të peshës.

4. GML

4.1. *Kategoria e gabimit mesatar X/GML për mjete matëset e kategorisë Y*

Tabela 1

Ngarkesa neto (m) në intervalet e shkallës së verifikimit (e)								Gabimi mesatar maksimal i lejueshëm	Gabimi maksimal i lejueshëm
XI	Y(I)	XII	Y(II)	XIII	Y(a)	XIII	Y(b)	X	Y
$0 < m \leq 50\,000$		$0 < m \leq 5\,000$		$0 < m \leq 500$		$0 < m \leq 50$		$\pm 0,5 \text{ e}$	$\pm 1 \text{ e}$
$50\,000 < m \leq 200\,000$		$5\,000 < m \leq 20\,000$		$500 < m \leq 2\,000$		$50 < m \leq 200$		$\pm 1,0 \text{ e}$	$\pm 1,5 \text{ e}$
$200\,000 < m$		$20\,000 < m \leq 100\,000$		$2\,000 < m \leq 10\,000$		$200 < m \leq 1\,000$		$\pm 1,5 \text{ e}$	$\pm 2 \text{ e}$

4.2. Devijimi standard

Vlera maksimale e lejueshme për devijimin standard të mjetit matës të klasës X (x) është rezultati i shumëzimit të faktorit (x) nga vlera në tabelën 2, si më poshtë.

Tabela 2

Ngarkesa neto (m)	Maksimumi i lejuar i devijimit standard për klasën X (1)
$m \leq 50 \text{ g}$	0,48 %
$50 \text{ g} < m \leq 100 \text{ g}$	0,24 g
$100 \text{ g} < m \leq 200 \text{ g}$	0,24 %

200 g < m ≤ 300 g	0,48 g
300 g < m ≤ 500 g	0,16 %
500 g < m ≤ 1 000 g	0,8 g
1 000 g < m ≤ 10 000 g	0,08 %
10 000 g < m ≤ 15 000 g	8 g
15 000 g < m	0,053 %

Për klasën XI dhe XII (x) duhet të jetë më pak se 1.

Për klasën XIII (x) nuk duhet të jetë më i madh se 1.

(¹) OJ L 46, 21.2.1976, f q. 1.

Për klasën XIII (x) duhet të jetë më I madh se 1.

4.3. *Intervalit i shkallës verifikuese— mjete matëset me një interval*

Tabela 3

Klasat e saktësisë		Intervalit i shkallës verifikuese	Numri i intervalit të shkallës verifikuese $n = \text{Max} / e$	
			Minimumi	Maksimumi
XI	Y(I)	$0,001 \text{ g} \leq e$	50 000	—
XII	Y(II)	$0,001 \text{ g} \leq e \leq 0,05 \text{ g}$	100	100 000
		$0,1 \text{ g} \leq e$	5 000	100 000
XIII	Y(a)	$0,1 \text{ g} \leq e \leq 2 \text{ g}$	100	10 000
		$5 \text{ g} \leq e$	500	10 000
XIII	Y(b)	$5 \text{ g} \leq e$	100	1 000

4.4. *Intervalit i shkallës verifikuese — mjete matëset me shumë intervale*

Tabela 4

Klasat e saktësisë		Intervalit i shkallës verifikuese	Numri i intervalit të shkallës verifikuese $n = \text{Max}/e$	
			Vlera minimale ⁽¹⁾ $n \geq \frac{\text{Max}}{e}$	Vlera maksimale $n \leq \frac{\text{Max}}{e}$
XI	Y(I)	$0,001 \text{ g} \leq e_i$	50 000	—
XII	Y(II)	$0,001 \text{ g} \leq e_i \leq 0,05 \text{ g}$	5 000	100 000
		$0,1 \text{ g} \leq e_i$	5 000	100 000
XIII	Y(a)	$0,1 \text{ g} \leq e_i$	500	10 000
XIII	Y(b)	$5 \text{ g} \leq e_i$	50	1 000

(1) Për $i=r$ zbatohet kolona korresponduese e tabelës 3, duke zëvendësuar e me e_r .

Ku:

$i = 1, 2, \dots, r$

i = Rangu i pjesshëm i peshimit

r = numri i përgjithshëm i rangjeve të pjesshme

5. Rangu i matjes

Në specifikimin e rangut të matjes për mjete matëset e klasës Y, prodhuesi duhet të llogarisë se kapaciteti minimal nuk duhet të jetë më pak se:

klasa Y(I)	:	100 e
klasa Y(II)	:	20 e për $0,001 \text{ g} \leq e \leq 0,05 \text{ g}$, dhe 50 e për $0,1 \text{ g} \leq e$
klasa Y(a)	:	20 e
klasa Y(b)	:	10 e
Shkallët e përdorura për klasifikim, p.sh. shkallët postare dhe peshoret e mbeturinave	:	5 e

6. Konfigurimi dinamik

- 6.1. Objekti i konfigurimit dinamik duhet të veprojë brenda një rangu të ngarkesës, të specifikuar nga prodhuesi.
- 6.2. Kur pajiset, një objekt i konfigurimit dinamik që kompenson për efektet dinamike të ngarkesës në lëvizje, duhet t'i ndalohej veprimi jashtë rangut të ngarkesës, dhe duhet të jetë e siguruar.

7. Performanca sipas faktorëve influencues dhe çrregullimeve elektromagnetike

- 7.1. GML-të për shkak të faktorëve influencues janë:

7.1.1. Për mjete matëset e kategorisë X:

- Për operime automatike; siç specifikohet në Tabelat 1 dhe 2,
- Për peshime statike në operime jo-automatike; siç është specifikuar në Tabelën 1.

7.1.2. Për mjete matëset e kategorisë Y

- Për çdo ngarkesë në operim automatik; siç specifikohet në Tabelën 1,
- Për peshime statike në operime jo-automatike; siç është specifikuar për kategorinë X në Tabelën 1.

- 7.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një çrregullimi është një interval të shkallës verifikuese.

- 7.3. Rangu temperaturor:

- Për klasën XI dhe Y(I) rangi minimal është 5 °C,
- Për klasën XII dhe Y(II) rangi minimal është 15 °C.

KAPITULLI III

Mjeti matës automatik gravimetrik për mbushje

1. Klasat e saktësisë

- 1.1. Prodheri duhet të specifikojë të dy klasat, klasën referente të saktësisë Ref (x) dhe klasën/klasat e saktësisë operacionale X (x).
- 1.2. Një lloji të mjetit matës i përcaktohet një klasë referente të saktësisë, Ref (X), që korrespondon me saktësinë më të mirë të mundshme për mjete matëset e llojit. Pas instalimit, mjete matëset individuale janë përcaktuar për një ose më shumë klasa operative të saktësisë, X (X), duke llogaritur produktet specifike që duhet të peshohen. Faktori i përcaktimit të klasës (x) duhet të jetë ≤ 2 , dhe në formën 1×10^k , $10^k 2 \times 5 \times 10^k$ ose ku k është një numër negativ i plotë ose zero.

1.3. Klasa referente e saktësisë, Ref(x) është e zbatueshme për ngarkesat statike.

1.4. Për klasën e saktësisë operacionale X (x), X është një sistem që ndërlidhet me saktësinë e peshës së ngarkesës dhe (x) është një shumëzues për kufijtë e gabimit të specifikuar për klasën X (1) në pikën 2.2.

2. GML

2.1. Gabimi i peshimit statik

2.1.1. Për ngarkesat statike nën kushtet e vlerësuara të funksionimit, GML për klasën referente të saktësisë Ref (x), duhet të jetë 0,312 e devijimit maksimal të lejuar të çdo mbushjes nga mesatarja; siç është specifikuar në Tabelën 5; shumëzuar me faktorin e përcaktimit të klasës (x).

2.1.2. Për mjete matëset ku mbushja mund të bëhet nga më shumë se një ngarkesë (p.sh. peshoret e kombinimit kumulativ ose selektiv), GML-ja për ngarkesa statike duhet të jetë saktësia e kërkuar për mbushjen, siç është specifikuar në pikën 2.2 (dmth. jo shuma e devijimit maksimal të lejuar për ngarkesa individuale).

2.2. Devijimi nga mbushja mesatare

Tabela 5

Vlera e masës, m (g), e , mbushjeve	Devijimi maksimal i lejueshëm për çdo mbushje nga mesatarja për klasën X(1)
$m \leq 50$	7,2 %
$50 < m \leq 100$	3,6 g
$100 < m \leq 200$	3,6 %
$200 < m \leq 300$	7,2 g
$300 < m \leq 500$	2,4 %
$500 < m \leq 1\,000$	12 g
$1\,000 < m \leq 10\,000$	1,2 %
$10\,000 < m \leq 15\,000$	120 g
$15\,000 < m$	0,8 %

Shënim:

Devijimi i llogaritur për çdo mbushje nga mesatarja mund të rregullohet për të llogaritur efektin e materialit të madhësisë së grimcave.

2.3. *Gabimi relativ për vlerën e para-vendosur (gabimi në konfigurim)*

Për mjete matëset ku është i mundur para-vendosja i një peshe të mbushjes; diferenca maksimale midis vlerës së para-caktuar dhe masës mesatare të mbushjes nuk duhet të tejkalojë 0,312 e devijimit maksimal të lejuar për çdo mbushje nga mesatarja, ashtu siç është specifikuar në Tabelën 5.

3. **Performanca sipas faktorit influencues dhe çrregullimit elektromagnetik**

3.1. GML-ja për shkak të faktorëve influencues duhet të jetë siç është specifikuar në pikën 2.1.

3.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një çrregullimi, është një ndryshim i treguesit të peshës statike ekuivalent me GML-në, siç është specifikuar në pikën 2.1 të llogaritur për mbushjen e vlerësuar minimale, apo ndryshimi që do të kishte dhënë efekt të njëjtë në mbushje, në rastin e mjete matëseve ku mbushja përbëhet nga ngarkesa të shumëllojshme. Vlera kritike e llogaritur e ndryshimit duhet të rumbullakohet në intervalin e ardhshëm më të lartë të shkallës (d).

3.3. Prodhuesi duhet të specifikojë vlerën e mbushjes së vlerësuar minimale.

KAPITULLI IV

Totalizatorët me ndërprerje

1. **Klasat e saktësisë**

Mjete matëset ndahen në katër klasa të saktësisë si në vijim: 0,2; 0,5; 1; 2.

2. **GML-të**

Tabela 6

Klasa e saktësisë	GML-ja e ngarkesës së totalizuar
0,2	± 0,10 %
0,5	± 0,25 %
1	± 0,50 %
2	± 1,00 %

3. **Intervali i shkallës së totalizimit**

Intervali i shkallës së totalizimit (d_t) duhet të jetë në rangun: $0,01 \% \text{ Max} \leq d_t \leq 0,2 \% \text{ Max}$

4. **Ngarkesa minimale e totalizuar ($\Sigma_{\min}$)**

Ngarkesa minimale e totalizuar ($\Sigma_{\min}$) duhet të jetë jo më pak se ngarkesa në të cilën GML-ja është ekuivalente me intervalin e shkallës së totalizimit (d_t) dhe jo më pak se ngarkesa minimale, siç është përcaktuar nga prodhuesi.

5. **Konfigurimi zero**

Mjete matëset që nuk peshojnë tarën pas çdo shkarkimi duhet të kenë një pajisje të konfigurimit zeros. Operimi automatik duhet të ndalohet në qoftë treguesi zero varion:

— 1 d_t në mjete matëset me pajisje për konfigurimin automatik zero;

— 0,5 d_t në mjete matëset me një pajisje gjysmë automatike, ose jo-automatike të konfigurimit zeros.

6. **Ndërfaqja e operatorit**

Rregullimet e operatorit dhe funksioni i rivendosur duhet të ndalohet gjatë operimit automatik.

7. **Printimet**

Në mjete matëset e pajisura me një pajisje printimi duhet të ndalohet rivendosja e totalit deri sa të printohet totali. Printimi i totalit duhet të ndodhë në qoftë se operimi automatik është ndërprerë.

8. **Performanca sipas faktorëve influencues dhe çrregullimet elektromagnetike**

8.1. GML-të për shkak të faktorëve influencues duhet të jenë siç janë specifikuar në Tabelën 7.

Tabela 7

Ngarkesa (m) intervalet e shkallës së totalizimit (d_t)	GM I
$0 < m \leq 500$	$\pm 0,5 d_t$
$500 < m \leq 2\,000$	$\pm 1,0 d_t$
$2\,000 < m \leq 10\,000$	$\pm 1,5 d_t$

8.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një çrregullimi është një interval i shkallës së totalizimit për çdo tregues peshe dhe çdo totali të ruajtur.

KAPITULLI V

Totalizatorët e pandërprerë

1. **Klasat e saktësisë**

Mjete matëset ndahen në tri klasa të saktësisë si në vijim: 0,5; 1; 2.

2. **Rangu i matjes**

2.1. Prodhuesi duhet të specifikojë rangun e matjes, raportin midis ngarkesës minimale neto në njësinë peshuese dhe kapacitetin maksimal, dhe ngarkesën minimale të totalizuar.

2.2. Ngarkesa minimale e totalizuar $\Sigma_{\min}$ nuk duhet të jetë më pak se 800 d për klasën 0.5,

400 d për klasën 1,

200 d për klasën 2.

Ku d është intervali i shkallës së totalizimit i pajisjes së përgjithshme të totalizimit.

3. GML

Tabela 8

Klasa e saktësisë	GML-ja për ngarkesën e totalizuar
0,5	$\pm 0,25 \%$
1	$\pm 0,5 \%$
2	$\pm 1,0 \%$

4. Shpejtësia e rripit

Shpejtësia e rripit duhet të përcaktohet nga prodhuesi. Për rripat peshues (beltweighers) me një shpejtësi, dhe rripat peshues me shpejtësi të ndryshueshme që kanë kontroll manual të vendosjes së shpejtësisë, shpejtësia nuk duhet të ndryshojë me më shumë se 5% të vlerës nominale. Produkti nuk duhet të ketë një shpejtësi të ndryshme nga shpejtësia e rripit.

5. Pajisja e totalizimit të përgjithshëm

Nuk duhet të jetë i mundur rikthimi në zero i pajisjes së totalizimit të përgjithshëm.

6. Performanca sipas faktorëve influencues dhe çrregullimeve elektromagentike

- 6.1. GML-ja për shkak të faktorit influencues, për një ngarkesë të jo më pak se Σ_{min} , do të jetë 0,7 herë sa vlera e duhur e specifikuar në Tabelën 8, e rrumbullakuar në intervalin më të afërt të shkallës së totalizimit (d).
- 6.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një çrregullimi duhet të jetë 0,7 herë sa vlera e duhur e specifikuar në Tabelën 8, për një peshë ekuivalente me Σ_{min} , për klasën e caktuar të rripit peshues; e rrumbullakuar deri në intervalin tjetër më të lartë të shkallës së totalizimit (d).

KAPITULLI VI

Peshorja automatike e vagonave

1. Klasat e saktësisë

Mjete matëset ndahen në katër klasa të saktësisë si në vijim: 0,2; 0,5; 1; 2.

2. GML

- 2.1. GML-të për peshimin në lëvizje të një vagoni të vetëm apo të të gjithë trenit janë dhënë në Tabelën 9.

Tabela 9

	Klasa e saktësisë	GML
0,2	$\pm 0,1 \%$	

0,5	$\pm 0,25 \%$
1	$\pm 0,5 \%$
2	$\pm 1,0 \%$

2.2. GML-të për peshën e vagonëve të shoqëruar ose të pashoqëruar të peshuar në lëvizje duhet të jenë një nga vlerat e mëposhtme, cilado që është më e madhja:

- vlera e llogaritur sipas tabelës 9, e rrumbullakuar në intervalin më të afërt të shkallës;
- vlera e llogaritur sipas Tabelës 9, e rrumbullakuar në intervalin më të afërt të shkallës për një peshë ekuivalente me 35% të peshës maksimale të vagonit (siç është e shkruar në shënjimet përshkruese);
- një interval i shkallës (d).

2.3. GML-të për peshën e trenit të peshuar në lëvizje duhet të jenë një nga vlerat e mëposhtme, cilado që është më e madhja:

- vlera e llogaritur sipas tabelës 9, e rumbullakuar në intervalin më të afërt të shkallës;
- vlera e llogaritur sipas tabelës 9, për peshën e një vagoni të vetëm të barabartë me 35% të peshës maksimale të vagonit (si është e shkruar në shënjimet përshkuese) shumëzuar me numrin referent të vagonëve (që nuk tejkalojnë 10) në tren, dhe të kompletuara për intervalin më të afërt të shkallës;
- një interval i shkallës (d) për çdo vagon në tren, por jo më tepër se 10 d.

2.4. Kur peshon vagonë të shoqëruar; gabimet e jo më shumë se 10% të rezultateve nga peshimi, të marra nga një ose më shumë kalime të trenit, mund të tejkalojnë GML-në e duhur të dhënë në pikën 2.2, por nuk duhet të kalojnë dy herë GML-në.

3. Intervali i shkallës (d)

Marrëdhënia në mes të klasës së saktësisë dhe intervalit të shkallës duhet të jetë në mënyrën e njëjtë siç specifikohet në Tabelën 10.

Tabela 10

Klasa e saktësisë	Intervali i shkallës (d)
0,2	$d \leq 50 \text{ kg}$
0,5	$d \leq 100 \text{ kg}$
1	$d \leq 200 \text{ kg}$
2	$d \leq 500 \text{ kg}$

4. Rangu i matjes

4.1. Kapaciteti minimal nuk duhet të jetë më pak se 1 t, dhe jo më shumë se vlera e rezultatit të peshës minimale të vagonit, e ndarë nga numri i peshimeve të pjesshme.

4.2. Pesha minimale vagonit nuk duhet të jetë më pak se 50 d.

5. Performanca sipas faktorit influencues dhe çrregullimit elektromagnetik

5.1. GML-ja për shkak të një faktori influencues duhet të jetë siç specifikohet në Tabelën 11.

Tabela 11

Ngarkesa (m) në intervalet e shkallës verifikuese (d)	GM I
$0 < m \leq 500$	$\pm 0,5 \text{ d}$
$500 < m \leq 2\,000$	$\pm 1,0 \text{ d}$
$2\,000 < m \leq 10\,000$	$\pm 1,5 \text{ d}$

5.2. Vlera kritike e ndryshimit për shkak të një çrregullimi është një interval i shkallës.

SHTOJCA IX

TAKSIMETRAT (MI-007)

Kërkesat përkatëse nga Shtojca I, kërkesat specifike nga kjo Shtojcë si dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të listuara në këtë Shtojcë që zbatohen tek taksimetrat.

PËRKUFIZIMET

Taksimetër

Është pajisje që punon me një gjenerues sinjali (1) që ta bëjë mjet matës.

Kjo pajisje matë kohën, llogarit distancën në bazë të sinjalit të dhënë nga gjeneruesi i sinjalit për largësi. Përveç kësaj, ajo llogarit dhe tregon tarifën që duhet paguar për udhëtimin në bazë të distancës së llogaritur dhe/ose kohës së matur të udhëtimit.

Tarifa

Gjithsej shuma e parave që duhet paguar për një udhëtim bazuar në një tarifë fikse fillestare dhe/ose gjatësinë dhe/ ose kohëzgjatjen e udhëtimit. Tarifa nuk është pagesë shtesë për shërbime shtesë.

Shpejtësia e kryqëzuar

Vlera e shpejtësisë që fitohet me pjesëtimin e vlerës së tarifës së kohës me vlerën e tarifës së largësisë.

Mënyra normale e llogaritjes S (aplikimi i tarifës njëshe)

Llogaritja e tarifës e bazuar në aplikimin e tarifës së kohës nën shpejtësinë e kryqëzuar si dhe aplikimin e tarifës së largësisë mbi shpejtësinë e kryqëzuar.

Mënyra normale e llogaritjes D (aplikimi i tarifës së dyfishtë)

Llogaritja e tarifës e bazuar në zbatimin e njëkohshëm të tarifës së kohës dhe tarifës së distancës gjatë gjithë udhëtimit.

Pozita e operimit

Mënyrat e ndryshme në të cilat taksimetri përmbush pjesët e ndryshme të funksionimit të tij. Pozitat e operimit dallohen sipas treguesve të mëposhtëm:

‘I lirë’	:	Pozita e operimit në të cilën llogaritja e tarifës është çaktivizuar
‘ I Angazhuar’	:	Pozita e operimit në të cilën llogaritja e tarifës bëhet në bazë të një pagese të mundshme fillestare si dhe e tarifës së distancës dhe/ apo kohës së udhëtimit.
‘I Ndalur’	:	Pozita e operimit në të cilën tarifa që obligohet për udhëtim është shënuar dhe së paku është çaktivizuar llogaritja e tarifës së kohës.

KËRKESAT E PROJEKTIMIT

